



FJALA E KRYEMINISTRIT THAÇI NË MBLEDHJE



Thaçi: Uroj të arrihen synimet e munguara tash e një shekull

Uroj që ky fillim i ri, ky kapitull i ri, të arrijë synimet e dëshiruara dhe qytetarët e Shqipërisë dhe Kosovës kudo që janë t'i gëzojnë frytet e këtij bashkëpunimi, të munguar tash e një shekull

faqe 4

BASHKËPUNIMI

Ministrja Kodheli, i paraprin takimit të Prizrenit

Ministrja e Mbrojtjes, Kodheli, vizitë zyrtare në Kosovë

faqe 5

FORCA TOKËSORE

Atashetë ushtarakë të Republikës së Kinës, takim me komandantin e FT

faqe 10

VIZITË ZYRTARE NË GREQI



Premtohet një bashkëpunim greko-shqiptar i ndryshëm dhe i ri

AVRAMOPOULOS: Shqipëria zë një vend të veçantë, jo vetëm në Evropën Juglindore, por në Evropë

KODHELI: Nënvizuam rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit në të ardhmen

faqe 6

FJALA E KRYEMINISTRIT RAMA NË MBLEDHJEN E PËRBASHKËT

Rama: Do të mundësojmë ripërkufizimin e hapësirës shqiptare

"Prizreni na kujton se s'do të kemi kurrë mundësitë dhe se nuk do t'i gjejmë kurrë të gjithë fjalët e duhura, për të falënderuar të gjithë ata që menduan e luftuan më shumë se 100 vjet për gjuhën tonë, ëndrrën tonë, qëllimin tonë dhe që sot nuk janë më"



faqe 3

PARTNERITET STRATEGJIK NDËRMJET SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Jehonë nga shkuara, premtim për të ardhmen



faqet 2-5

SPECIALE

Mendimi ushtarak i Ismail Qemalit për FA



Për të krijuar Forcat e Armatosur, në rrethanat e atëhershme, Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe Ismail Qemalit i duhej një strategji. Strategjia ishte e thjeshtë. Siç del nga dokumentacioni i kohës, i Qeverisë së Vlorës, sipas kësaj strategjie, fillimisht, në fazën e parë synonte mbrojtjen e vendit nga copëtimi. Në planin e brendshëm vendi vuante e përjetonte vështirësi të rënda ekonomike, shoqërore, politiko-ushtarake, si dhe të pasigurisë publike, që ishin rrjedhojë e mungesës së shtetit me institucionet e tij

faqe 8-9

ANALIZA

Transformimi - ambicie dhe sfidë e Forcave të Armatosura për 2014

faqe 12

ALEANCA

NATO, aktivitetet kryesore të zhvilluara në vitin 2013

faqe 11

FORCA DETARE

Promovimi i figurës së nënoficerit më të mirë në FD

faqe 15

PËRFAQËSIMI



Ndërrohet atashu ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, priti në datë 14 janar 2014, në një takim të veçantë atashen ushtarak të SHBA në vendin tonë, kapiten i rangut të dytë Glenn Brown me rastin e përfundimit të detyrës...

faqe 10

PARTNERITET STRATEGJIK NDËRMJET SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Takimi i Prizrenit, jehonë nga shkuara, premtim për të ardhmen

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë kanë zhvilluar në datën 11 janar 2014, në Prizren një mbledhje të përbashkët, ku janë diskutuar tema të rëndësishme, me synim thellimin e bashkëpunimit ndër-shtetëror mes dy vendeve. Mbledhja është hapur me fjalimin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi dhe atë të kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Edi Rama. Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi në fjalën e tij në mbledhjen e përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë theksoi se “qëllimi i këtij takimi mes dy qeverive, dhe i atyre të ardhshme, ka për të qenë pikërisht përshtetimi apo përmirësimi i zbatimit të marrëveshjeve të mëhershme dhe njëherazi zgjerimi dhe thellimi i bashkëpunimit bilateral nëpërmjet hartimit të marrëveshjeve të reja”. Z.Thaçi potencoi se “adoptimi i praktikës së mbledhjeve të përbashkëta nga dy qeveritë, nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Shqipërisë është relativisht e vonuar, duke patur parasysh se sa shumë herë janë organizuar këto mbledhje të përbashkëta qeveritare në rajon. Për këtë arsye lindë nevoja që mbledhjet ardhshme të përbashkëta duhet të jenë edhe më të ngjeshura e të ngarkuara me punë, për të kompensuar kohën e humbur dhe për të kapur ritmin e vendeve të tjera të rajonit”. Kryeministri Thaçi deklaroi gjithashtu se “nëpërmjet mbledhjes zotohemi jo vetëm që të bëjmë çmos për përmirësimin e marrëdhënieve mes qytetarëve të shteteve respektive, por edhe që të marrim përsipër përgjegjësinë historike për t’u kujdesur për bashkombasit që gjenden pakicë në rajon si dhe për të forcuar lidhjet me mbarë diasporën”. Për këtë arsye, shtoi z.Thaçi, edhe dy produktet më thelbësore konkrete që dolën nga mbledhja lidhen me shqiptarët e rajonit të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit. Njëra nismë ka të bëjë me miratimin e financimit të kompletimit me pajisje mjekësore të maternitetit të Preshevës, ndërsa tjetra është nisma për krijimin e një fondi zhvillimor për shqiptarët e rajonit të Luginës së Preshevës. Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, në fjalimin e tij para dy kabineteve qeveritare u shpreh se “ajo që kishte bërë bashkë sot, në një tryezë të bashkëqeverisjes strategjike, Qeverinë e Shqipërisë dhe Qeverisë e Kosovës, ishte një nismë që ka të bëjë pikë së pari, me kontributin tonë për integrimin shqiptar dhe rajonal në Evropën e bashkuar, si shprehje e vendosmërisë sonë të përbashkuar për



ta jetësuar këtë integrim si hapësire evropiane të tej kufijve”. Z.Rama e quajti këtë nismë si “pikënisje të një rrugëtimit të përbashkët institucional, drejt zhvillimit të vendeve tona; forcimit të ekonomive tona; modernizimit të shteteve tona; transformimit të arsimit shqipfolës; pasurimit të jetës sonë kulturore; ripërtëritjes së vazhdueshme të shoqërive tona dhe shtimit dhe fuqizimit të ndërlidhjeve mes tyre”. Më tej kryeministri Edi Rama tha se dëshiron të ketë mbledhje të përbashkëta edhe me qeveri të tjera, vende të tjera, partnere strategjike ose partnere të çmuara në rrugën tonë drejt demokratizimit, modernizimit dhe integritit tonë rajonal e evropian. Mirëpo sipas z.Rama: “do të ishte mungesë e madhe sinqeriteti që ta fshihja se mbledhja me qeverinë e Kosovës është një eksperiencë unike, e replikueshme në formë, por jo në thelb. Sepse gjuha jonë është një, ëndrra jonë është një, qëllimi ynë i përbashkët është vetëm një”- theksoi kryeministri Rama. Në mbledhjen e parë të përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë janë shqyrtuar:

1. Dokumenti për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë
2. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim në Lehtësimin e Tregtisë
3. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim në fushat e Transportit dhe Infrastrukturës
4. Propozimi për Bashkëfinancim të pajisjeve mjekësore të Maternitetit të Preshevës
5. Propozimi për përfaqësimin e përbashkët konsullor midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së

Shqipërisë

6. Marrëveshja për Bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë
 7. Marrëveshja për Bashkëpunim në fushën e zhvillimit ekonomik dhe të energjisë
 8. Themelimi i iniciativës për Fondin Zhvillimor për Luginën e Preshevës
 9. Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e kulturës dhe aktivitetet për ndërtimin e kalendarit të përbashkët kulturor
 10. Propozimi për bashkëfinancimin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit DOKUFEST në Prizren;
 11. Propozimi për heqjen e taksës së TVSH-së apo taksës tjetër doganore për importin e librit nga Shqipëria
 12. Dorëzimi i legjislacionit të BE-së të përkthyer në gjuhën Shqipe nga Ministria e Integritit Evropian e Republikës së Shqipërisë te Ministria e Integritit Evropian e Republikës së Kosovës
 13. Themelimi i Komisionit të Përbashkët Teknik për përkthimin e legjislacionit të BE-së, si dhe bashkëpunimit në sferën e përafritimit të legjislacionit ndërmjet Ministrisë së Integritit Evropian të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Integritit Evropian të Republikës së Kosovës
- Pas mbledhjes, në një ceremoni të organizuar në ambientet e Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u bë nënshkrimi zyrtar i Dokumentit për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve tjera të arritura mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Disa pyetje - përgjigje me shtypin, pas deklaratës

Për sa i përket Marrëveshjes së Partneritetit Strategjik, a përfshihet në të bashkimi i shërbimit diplomatik mes Kosovës dhe Shqipërisë?

Kryeministri Rama: Është me rëndësi të theksohet se do të avancojmë për të

sinkronizuar burimet tona financiare në aspektin e shërbimit konsullor. Kjo është me rëndësi të theksohet, për të racionalizuar shfrytëzimin e këtyre burimeve dhe për të lehtësuar shërbimet për bashkëqytetarët tanë përmes konsullatave tona.

Ju sot i dhatë mbështetje të gjithë qytetarëve shqiptarë të Luginës së Preshevës. A do të vazhdojë përkrahja nga të dy qeveritë, për qytetarët e Luginës së Preshevës?

Kryeministri Rama: Ne sot i kemi dhënë formën përfundimtare një angazhimi të marrë, një zotimi që ka qenë i përbashkët, për të asistuar dhe finalizuar përpjekjen për të ndërtuar maternitetin dhe për t’u dhënë mundësi nënave të reja në Luginë, që ta marrin shërbimin e nevojshëm brenda komunave përkatëse dhe përkatësisht duke filluar nga komuna e Preshevës. Është një domosdoshmëri, por është njëkohësisht edhe një gjest sa simbolik, aq edhe i nevojshëm për të krijuar kushtet që fëmijët në atë Luginë të lindin normalisht, pa krijuar detyrimin për nënat e reja që të marrin dhjetëra e dhjetëra kilometra të tëra jashtë Luginës, për një shërbim që nuk është vetëm shërbim vetëm i një dite, por është shërbim në vazhdimësi. Nga ana tjetër, kemi rënë dakord edhe për krijimin e një fondi zhvillimor, një fondi me natyrë humanitare, që në vijimësi do të asistojë në funksion të lehtësimit të kushteve jashtëzakonisht të vështira, ekonomike dhe sociale të shqiptarëve të Luginës dhe sigurisht, në koherencë të plotë me angazhimin tonë kushtetues, por angazhimin tonë edhe politik dhe publik, besoj të përbashkët, është e qartë, të së dy qeverive për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve kudo ku ata jetojnë.

Cili dhe çfarë ndryshimi do të sjellë ky Partneritet Strategjik për qytetarët e Shqipërisë dhe të Kosovës dhe sipas jush, çfarë impakti do të ketë në rajon dhe në rrugën e Shqipërisë dhe të Kosovës drejt integritit evropian?

Kryeministri Rama: Në qoftë se ka një dallim esencial midis atij që ka qenë “bashkëpunim i derikëtushëm” dhe atij që do të jetë bashkëpunimi që këtu e më tutje, është pikërisht se bashkëpunimi “që këtu e më tutje” do të jetë bashkëpunim i bazuar në domosdoshmërinë për të krijuar rezultat. Rezultat konkret në çdo fushë; rezultat konkret në përfitim të qytetarëve tanë këtej dhe andej kufirit; rezultat konkret në funksion edhe të bashkimit të rrugëve tona në rrugën e BE-së. Padyshim, edhe rezultat konkret në forcimin e imazhit të Shqipërisë dhe të Kosovës, si dy shtete që promovojnë mbrojtjen e pakicave, promovojnë shumëllojshmërinë e besimeve, promovojnë pa as më të voglin dyshim, një demokraci dhe një tolerancë, për të cilën jo vetëm popujt tanë në të gjithë rajonin, por edhe vetë Evropa ka nevojë të vazhdueshme.

Zoti Rama, thatë se mbledhja e ardhshme do të jetë në Vlorë. A do t’i ftoni edhe përfaqësuesit e Maqedonisë, kryeministrin e Maqedonisë, apo do të prisni që edhe një kohë e gjatë të shkojë, derisa të vijë në pozitën e kryeministrit apo të jetë homolog një shqiptar?

Kryeministri Rama: Ne do të bëjmë mbledhje të përbashkët të qeverisë së Shqipërisë dhe të Kosovës. Nuk kuptoj çfarë hyn kryeministri i Maqedonisë në një mbledhje të përbashkët të qeverisë së Shqipërisë dhe të Kosovës. Ndërkohë që, siç e thashë edhe unë, edhe kryeministri Thaçi, ne duam dhe do të bëjmë mbledhje të kësaj natyre edhe me qeveri të tjera, por është e kot që ta fshehim se në formë, kjo është formë e njohur dhe e replikueshme, kurse në thelb, mbledhja e përbashkët mes qeverive të Shqipërisë dhe Kosovës është unike dhe e pareplikueshme. *Sa do të jetë fondi që do të dedikohet për Luginën, kur dihet se një qeveri serbe dedikon miliona euro për serbet e Veriut të Kosovës?*

Kryeministri Rama: Ne nuk besoj se jemi në garë duke numëruar milionat. Ne jemi në garë për kohën e humbur dhe fondi që ne do të dedikojmë lidhur me maternitetin është mbulimi i të gjitha nevojave për pajisjen e maternitetit të Preshevës. Ashtu sikundër, kur flasim për fondin zhvillimor, ai do të jetë një fond i hapur ku jo vetëm qeveritë, por edhe të tjerë, institucione, sipërmarrje, individë do të mund të japin kontributin e tyre, në funksion të asaj natyre që ka fondi në fjalë, që e përcaktoi fare mirë kryeministri Thaçi duke e quajtur një fond humanitar, për t’i ardhur në ndihmë e për të lehtësuar kushtet jashtëzakonisht të vështira, ekonomike dhe sociale, në të cilat jetojnë vëllezërit dhe motrat tona në Luginë.

Fjala e Kryeministrit Rama në mbledhjen e parë të përbashkët mes Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës, mbajtur në Prizren

“Do të mundësojmë ripërkufizimin e hapësirës shqiptare”

“Fort i nderuar Kryeministër i Kosovës!

Të nderuar ministra dhe ministre të Qeverisë së Kosovës dhe të Shqipërisë,

Shumë të dashur bashkëkombës,

Të respektuar bashkëqytetarë të së gjitha etnive që ndiqni këtë takim kaq të posaçëm!

“Nuk janë projektet, nuk janë nevojat, nuk është bindja e përplotësimit në shumë fusha, nuk është as vizioni, as lidhshipi, por është vendosmëria që solli suksesin e bashkëpunimit të tyre”,

- thuhet në një prej analizave të goditura për suksesin e kooperimit mes vendeve të BENELUX-it, të cilat për shumë analistë të BE-së konsiderohen si pararojë e integritimit, shembull i suksesit dhe laborator i testit për shumë aspekte të integritimit evropian. Modestish mendoj se ajo që na ka bërë bashkë sot, në një tryezë të bashkëqeverisjes strategjike, Qeverinë e Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës, është një nismë që ka të bëjë pikë së pari, me kontributin tonë për integritimin shqiptar dhe rajonal në Evropën e bashkuar, si shprehje e vendosmërisë sonë të përbashkuar për ta jetësuar këtë integritim si hapësirë evropiane të tej-kufijve. Parafytyrimi i kahershëm i pararendësve tanë, e pastaj dhe jetësimi prej nesh i kësaj hapësire me kthjelltesinë e me vendosmërinë e përbashkuar, ndaj dhe të forcuar, për përkatësinë tonë jo vetëm ndaj një kombi, por njëkohësisht ndaj projektit tonë për Evropën e bashkuar, e kthen së dyti këtë nismë në pikënisjen e një rrugëtimit të përbashkët institucional, drejt zhvillimit të vendeve tona; forcimit të ekonomive tona; modernizimit të shteteve tona; transformimit të arsimit shqipfolës; pasurimit të jetës sonë kulturore; ripërtëritjes së vazhdueshme të shoqërive tona dhe shtimit dhe fuqizimit të ndërlidhjeve mes tyre. Është e vërtetë se ne jemi më shumë se qytetarë të dy shteteve fqinje, sepse shumica dërrmuese e qytetarëve tanë i takojnë një kombi që me gjithë diferencat e brendshme, kanë një gjuhë, një kulturë dhe një traditë të përbashkët. Por, nëse mbledhja e përbashkët e dy qeverive, një kombi të shtrirë në dy shtete, bëhet arsye trembjeje, apo nga ana tjetër inkurajimi, për këdo që ka shqetësime në lidhje me vijat kufitare, dua ta them kryekreje, kthjellët dhe fort, se kufiri mes Shqipërisë dhe Kosovës është për ne shumë i qartë dhe i patjetërsueshëm, si një vijë që na kujton, qoftë pamundësinë e historisë nga njëra anë, apo përpjekjen heroike që solli krijimin e shtetit të dytë shqiptar nga ana tjetër, dhe qoftë edhe detyrimin tonë për t'i qëndruar besës së dhënë atyre, pa të



cilët Kosova e lirë dhe pavarur do të kishte mbetur një ëndërr e përgjakur, SHBA-ve dhe BE-së. E, të gjithë duhet ta dinë që ne e dimë fort mirë se liria, demokracia dhe dinjiteti i një kombi nuk kanë të bëjnë me kufijtë shtetërorë, por me qeverisjen dhe aspiratat e saj për shtetin, si dhe me vlerat e patjetërsueshme të respektit, qoftë për detyrimet ndaj familjes së shteteve ku duam të integrohemi plotësisht, si anëtarë të denjë, qoftë për detyrimet ndaj çdo anëtarë të familjeve të dy shteteve tona, që nuk i përket kombësisë sonë. Qeveria e Shqipërisë sot është qeveria e “Aleancës për Shqipërinë Evropiane”. “Aleanca për Shqipërinë Evropiane” ka ardhur në qeverisje me një program të qartë të Shqipërisë Evropiane, si model frymëzimi, faktor paqeje dhe stabiliteti demokratik në rajon, si partnere strategjike e SHBA-ve dhe BE-së. Qeveria jonë ka dalë nga një shumicë e mbështetur me një votë plebishitare, e cila e ka deklaruar dhe nënvizuar pa ekuivokë qëllimin e zhvillimit të gjithanshëm të një partneriteti paqësor dhe strategjik me Kosovën. Kjo nismë, qenia jonë sot këtu, është pikë se treti, mbajtja e një zotimi për të cilin Shqipëria votoi dhe fillimi i jetësimin në një tërësi aspektesh, i vizionit tonë të ri të bashkëpunimit me Kosovën. Bashkëpunimi i kahershëm i vendeve të BENELUX-it dhe bashkëpunimi i mëvonshëm, por që përfshin shumë aspekte novatore edhe i vendeve nordike, janë frymëzim për ne, në këtë kohë të re që ka filluar për Evropën Juglindore. Është një kohë sfidash dhe mundësish të mëdha që nëpërmjet bashkimit të vendosmërisë, këtej dhe andej kufirit, do të mundësojë ripërkufizimin e hapësirës shqiptare, duke e trajtuar atë të tërën bashkë, si burim mirëqenie për qytetarët e dy shteteve tona dhe si gjeneratorë, jo vetëm shqiptarë, por rajonal dhe evropianë, sigurisht. Sakaq, janë të mirëpritur si pjesë e kundërvënies së natyrisht demokratike edhe mohuesit e brendshëm të cilët këtë nismë, në mbledhjen e dy qeverive në Prizrenin e çmuar të historisë së kombit shqiptar,

e cilësuan pa ndodhur dhe me gjasë do ta rikonfirmojnë paçka se ndodhi, thjeshtë si një shfaqje patriotike, madje konsum mediatik. Gjithsesi, ajo çfarë ka rëndësi, besoj unë, është se kjo nismë që të marrë kuptimin e merituar, siç ndoshta dhe vetë mohuesit e rastit dëshirojnë, nuk mund të mbetet vetëm në kuadrin e një bashkëpunimit qeveritar, por duhet të zhvillohet më tej dhe si projekt i përbashkët i të gjithëve, edhe i opozitës në të dyja vendet, dhe i shoqërisë civile, dhe i botës akademike, dhe i sipërmarrjes së lirë dhe i gjithë qytetarëve të interesuar padyshim. Sepse historia apo rasti e deshën që të jemi ne, të pranishmit këtu, inauguruesit e kësaj faze të re të historisë së marrëdhënieve mes nesh, Shqipërisë dhe Kosovës. Por, pa pikë dyshimi, përkohshmëria demokratike e mandatave tona e bën të vetëkuptueshëm faktin se rruga e re e bashkëpunimit që inaugurojmë sot mbetet të zhvillohet ende më tutje dhe shumë më tutje sesa kufiri kohor i detyrës sonë. Me këtë vetëdije dhe qasje, besoj, kjo rrugë mund të plotësohet me dimensionin e saj të katërt, që është mobilizimi i imagjinatës gjithëkombëtarë për parafytyrimin, krijimin dhe jetësimin e perspektivave të reja dhe të ndryshme të bashkëpunimit. Në fjalën time në Parlamentin e Kosovës pata mundësinë e privilegjuar të nënvizoj rreth 15 perspektiva konkrete bashkëpunimi, për shumë prej të cilave, hapat e parë do të hidhen në këtë mbledhje, që realizohet veç pak më shumë se 100 ditë larg deklarimit për mbajtjen e saj. E, për sa ju përket këtyre perspektivave konkrete dua të qëndroj një dekim, tek ajo ç'ka kemi deklaruar në dakordësi të plotë mes nesh, se një rëndësi e posaçme duhet dhe do t'i jepet mbështetjes dhe mbrojtjes me vendosmëri të bashkuar të drejtave të shqiptarëve përtej kufijve tanë zyrtarë. Për të ri-shënjuar këtë vendosmëri, kjo mbledhje përfshin një gjest të shumëpritur qoftë nga Tirana, qoftë nga Prishtina dhe jo thjesht simbolik, në mbështetje të shqiptarëve të Preshevës. Vendosmëri kjo, që në anën

tjetër të medaljes ka angazhimin e dy shteteve shqiptare në mbrojtje të çdo pakice dhe promovimin e të drejtave të pakicave në gjithë rajonin. Ne jemi të gjithë krenarë për Kosovën, e cila doli e përgjakur nga një sundim i gjatë ku u trajtua si pakicë për t'u shtypur dhe spastruar, dhe pastaj nga një luftë e madhe ku humbi shumë e bij dhe bija, por jo vetëm nuk ktheu pavarësinë e vet republikane, të fituar me urtësi e me gjak, në një forcë shtypëse ndaj pakicave, por u kthye e tëra në modelin më shembullor të rajonit për mbrojtjen dhe respektin ndaj pakicave. Guximin tuaj, të dashur vëllezër e motra, për dialog me armikun e deridjeshëm dhe frytet e dialogut me fqinjin e gjithëshëm në rrugën e të ardhmes, jam i bindur se koha që vjen do t'i çmojë gjithnjë e më shumë e bukur më mirë se ne, si vlerë të një historie frymëzuese, të cilën ju po e shkruani sot dhe brezat do ta lexojnë nesër, me mirënjohjen për frytet në vijimësi që e tashmja do të sjellë në të ardhmen, qoftë për gjeneratën tjetër të shqiptarëve të Kosovës, qoftë për gjeneratën tjetër të serbëve në Serbi. Dhe, me admirimin për shembullin rrezatues të respektit ndaj pakicave, që përmes Kosovës, në radhë të parë, shqiptarët si komb japin sot për rajonin dhe për qytetërimin evropian dhe gjithashtu, me shumë modesti përballë fqinjëve dhe partnerëve tanë, më lejoni ta vendos në krye të fjalisë tjetër togfjalëshin tonë popullor që thotë - “o na takon ne, o si takon kujt”, të mbrojmë shumëllojshmërinë e etnive, gjuhëve, besimeve fetare kudo ku i ndeshim në rrugën tonë, brenda ose jashtë vendit ku jetojmë. Perspektivat që kemi vizuar dhe fushat që kemi cekur në rrugën e derikëtueshme të angazhimit të përbashkët, për bashkëpunim të thelluar e të zgjeruar mes nesh, sot nisin të konkretizohen prej dy qeverish të angazhuara, me mendje e me zemër, me shtrimin e një rrugë gjithnjë e më të përbashkët, me vullën e deklaratës së përbashkët për bashkëpunim dhe partneritet strategjik. Padyshim, këto perspektiva, bashkë me projektet e

përmendura në këtë deklaratë themeltare nuk janë shteruese. Të tjerët pas nesh apo edhe ne vetë, përgjatë rrugës që do na takojë ta bëjmë dorë përdore, qeveri më qeveri, do të mund t'i pasurojmë me risitë që, pa pikë dyshimi, të gjitha nivelet e shoqërive tona do të prodhojnë në kuadrin e gjerë të ndërveprimit tej-qeveritar. Prandaj dhe jam shumë i bindur se sot hapim një proces që, duke u zgjeruar edhe në rrahë të tjerë përtej rrethit të dy qeverive, do të jetë një kontribut shumë më i madh se ç'mund të parashikohet pa të, në rrugën e integritimit evropian. Bash ashtu siç pati një efekt të paparashikuar, qoftë edhe në kuadër ekspertësh shumë të njohur që kontribuuan për BE-në, eksperiencia e bashkëpunimit të vendeve me përmasa shumë të vogla, por që i dhanë në fakt, jo veç emrin por shumë më tepër se emrin, disa marrëveshjeve kyçe për pasurimin dhe përsosjen e integritimit evropian dhe të vetë projektit të BE-së. Edhe me qeveri të tjera, vendesh të tjera, partnere strategjike ose partnere të çmuara në rrugën tonë drejt demokratizimit, modernizimit dhe integritimit tonë rajonal e evropian, duam dhe me siguri do të kemi mbledhje të përbashkëta. Por do të ishte mungesë e madhe sinqeriteti që ta fshihja sot, se kjo, me qeverinë e Kosovës është një eksperiencë unikalë, e replikueshme në formë, por jo në thelb. Sepse gjuha jonë është një, ëndrra jonë është një, qëllimi ynë i përbashkët është vetëm një.

Ne jemi bashkudhëtarë që ecim bashkë, duke folur të njëjtën gjuhë, me të njëjtën ëndërr, për të njëjtin qëllim dhe me vendosmërinë e bashkuar drejt të njëjtit destinacion, në hapësirën evropiane të tej-kufijve. “Bashkudhëtari im, ta provojmë vetveten derisa kemi frymë”, - thotë një pendë ndër më të ndriturat e shqipes sonë, Ali Podrimja. Me këto fjalë kumbuese të tij, sot kam nderin dhe përlësinë ta mbyll këtë fjalë timen, duke falënderuar me zemër dhe mirënjohje vëllanë, mikun dhe kolegun Hashim Thaçi, ju të gjithë dhe të gjithë ata, në Kosovë e në Shqipëri, që në të përditshmen tonë janë politikisht me ne apo politikisht kundër nesh, por nuk bëjnë dallim nga ne, kur vjen fjala tek gjuha, kur vjen fjala tek ëndrra, kur vjen fjala tek qëllimi dhe destinacioni që neve sot na ka mbledhur këtu, në Prizrenin e lidhjes së madhe të shqiptarëve, në Prizrenin që na kujton se s' do të kemi kurrë mundësitë dhe se nuk do t'i gjejmë kurrë të gjithë fjalët e duhura, për të falënderuar të gjithë ata që menduan e luftuan më shumë se 100 vjet për gjuhën tonë, ëndrrën tonë, qëllimin tonë dhe që sot nuk janë më. Sepse pa ta, ne nuk do të ishim kurrë dot, sot këtu ku jemi, as kjo mbledhje nuk do të mbahej dot, mbase për 100 vjet të tjera.

Faleminderit!”

Fjala e kryeministrit Thaçi në mbledhjen e përbashkët në Prizren

“Uroj të arrihen synimet e munguara tash e një shekull”

*I nderuari kryeministër i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, të Republikës së Shqipërisë, dhe të gjithë ata qytetarë që janë duke shikuar këtë takim tonë të përbashkët, të parin në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.*

Më lejoni fillimisht i nderuari kryeministër Rama, t’ju falënderoj për gatishmërinë tuaj, idenë tuaj dhe angazhimin tuaj, që ky takim të ndodhë shpejt, të ndodhë në mënyrë efikase, prandaj sot jemi këtu në qytetin e bukur në qytetin e krenarisë sonë kombëtare, në qytetin e historisë në qytetin e së ardhmes, në qytetin e tolerancës dhe bashkëjetesës, në qytetin e Prizrenit. Më lejoni t’i falënderoj edhe qytetarët e Prizrenit, për mikpritjen e tyre që i bënë të dy Qeverive, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Më lejoni të theksoj disa nga bazat kryesore mbi të cilat do të ndërtohet strategjia e bashkëpunimit të dy vendeve, Shqipërisë dhe Kosovës. Ne sapo përmbyllim takimin e parë të dy qeverive tona, një takim shumë i suksesshëm. Në fushën e politikës së Jashtme dhe Sigurisë, të dy qeveritë do të angazhohen në fuqizimin e bashkëpunimit dhe intensifikimit të dialogut ndërqeveritar për të gjitha çështjet me interes të ndërsjellë. Këto çështje përfshijnë bashkërendimin, në angazhimin e Kosovës në proceset dhe në iniciativat rajonale. Koordinimin dhe mbështetjen për proceset integruese evropiane dhe euroatlantike. Thellimin e bashkëpunimit në fushën e politikës së jashtme, mbështetje për avancimin dialogut, ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Ndër të tjera bashkëpunimi në këto fusha synon, koordinimin e përpjekjeve në drejtim të konsolidimit të pozitës dhe subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, përmes shtimit të njohjeve, anëtarësimit në mekanizma tjerë rajonal dhe ndërkombëtarë me synim final anëtarësimit të Republikës së Kosovës në OKB, në BE dhe në NATO. Në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, synohet që përmes bashkëpunimit në mes të institucioneve të zbatimit të ligjit, gjyqësorit të vendosen bazat e shkëmbimit të përvojave në proceset e reformimit të shtetit të së drejtës, në përputhje me standardet evropi-



ane, standardet ndërkombëtare. Në këtë mënyrë nëpërmjet projekteve të përbashkëta, objektivi kryesor i qeverive të dy vendeve do të bazohet në ofrimin që për qytetarët tanë te kemi standarde të larta të sigurisë, shkëmbim të intensifikuar të informacionit në luftën kundër trafikimit të organizuar, trafikëve dhe korrupsionit.

*I nderuari kryeministër Rama,
Të nderuar të pranishëm,
Të nderuar bashkëqytetar,*
Strategjia e bashkëpunimit ekonomik, përkatësisht në fushën e ekonomisë, energjisë, transportit, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit, do të përbëjë përkushtim kryesor të dy qeverive. Përmes kësaj, synojmë të ofrojmë një klimë nxitëse për bizneset në një treg të integruar duke shfrytëzuar në mënyrë sa më efektive dhe racionale të potencialeve tona të përbashkëta. Një theks të veçantë do t’i kushtohet energjetikës duke komplimentuar sistemet tona hidro dhe termo dhe duke vendosur një sistem të përbashkët energjetik. Rëndësi e veçantë do t’i kushtohet pjesëmarrjes së Kosovës në TAP, bashkëpunimi në fushën e turizmit dhe telekomunikacionit. Arsimi dhe Sporti do të zënë vend kryesor në qasjen tonë të përbashkët. Krijimi i mekanizmave për politika të përbashkëta në kërkime dhe arsim, organizimi të kampionateve të përbashkëta sportive, të gjitha këto në frymën e bashkëpunimit dhe integritetit evropian. Duke marrë parasysh afërsinë kulturore dhe historike, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, me përkushtimin më të madh do të angazhohen në ruajtjen dhe promovimin e identitetit të përbashkët kulturor dhe kombëtar. Kjo do të arrihet përmes hartimit

të planeve të përbashkëta dhe strategjive zhvillimore. Mbështetjen e projekteve të përbashkëta kërkimore, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të kulturës për krijimin e kalendarit të përbashkët vjetor. Në këtë drejtim nuk do të lihen anash as bashkatdhetarët tanë, kudo që jetojnë në rajon, por edhe në diasporë, shqiptarët në Maqedoni, Preshevë dhe Mal të Zi. Në të gjitha fushat e bashkëpunimit qasja shqiptare do të jetë fokusi ynë, prandaj edhe kemi vendosur formimin e një fondi monetar të përbashkët për zhvillimin e Luginës së Preshevës. Ky vendim shkon në vazhden e vendimeve tjera që qeveritë e vendeve tona, që kanë ndërmarrë në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të qytetarëve shqiptarë kudo që jetojnë përfshirë edhe ata në Luginën e Preshevës. Për arritjen e këtyre objektivave do të hartohet strategji dhe plane konkrete në fushat përkatëse. Ministritë përkatëse do të marrin përgjegjësitë për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të marra në mbledhjen e dy qeverive tona. Po ashtu, do të krijojmë komisione të përbashkëta për fusha të ndryshme më theks të veçantë në komisionet e përbashkëta për ekonomi. Dëshiroj t’i uroj të gjithë qytetarët në Shqipëri, Kosovë dhe kudo për mbështetjen dhe besimin e tyre. Uroj që ky fillim i ri, ky kapitull i ri, të arrijë synimet e dëshiruara dhe qytetarët e Shqipërisë dhe Kosovës kudo që janë t’i gëzojnë frytet e këtij bashkëpunimi, të munguar tash e një shekull. Uroj që ky bashkëpunim të shërbejë në të mirë të zhvillimit të vendeve tona dhe të rajonit për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët të rajonit, për Kosovën evropiane, për Shqipërinë evropiane dhe rajonin evropian.

Rama: Kjo mbledhje vuri një gur themeltar zhvillimi

Pjesë nga fjala e Kryeministrit Rama pas nënshkrimit të marrëveshjeve mes Qeverisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës

“Përshëndetje të gjithëve,

Me lejoni që, që në fillim të shpreh emocionin tonë të posaçëm për këtë ditë dhe për këtë moment, duke shprehur në radhën më të parë, përlulesisht, mirënjohjen për të gjithë ata që nuk janë më, apo ata që sot janë dëshmitarë të kësaj dite dhe që u përpoqën, u sakrifkuan, dhanë edhe jetën që rruga e shqiptarëve të mbërrinte edhe te ky stacion, ku ne sot jemi mbledhur, në Prizrenin simbol. Simbol shqiptar, por edhe simbol evropian; simbol shqiptar i bashkëjetesës së historive, të kulturave, të besimeve dhe të etnive. Nga ana tjetër, me lejoni të nënvizoj se kjo mbledhje ishte një mbledhje pune dhe një mbledhje që vuri një gur themeltar, duke çelur një rrugë të re për zhvillimin e gjithanshëm ekonomik, social dhe kulturor në dy shtetet tona dhe në mbarë hapësirën shqiptare që përkufizojnë këto dy shtete. Dua ta filloj nga deklarata e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritet strategjik, që është guri i themelit i një strategjie të përbashkët për hartimin, miratimin dhe zbatimin e politikave të përbashkëta në planin politik, ekonomik, social dhe kulturor. Të gjitha këto politika janë në funksion të përmirësimit të jetës, të jetës së përditshme të qytetarëve tanë, të jetës së përditshme në dy shtetet tona, në funksion të jetës të gjeneratave të tjera dhe në përputhje me objektivin e përbashkët të dy shteteve shqiptare për t’u bërë pjesë e BE-së. Deklarata e përbashkët mbështetet në katër shtylla kryesore: Bashkëpunimi në fushën e politikës së jashtme dhe sigurisë; çështjet e brendshme; ekonomia, arsimit dhe kultura, së bashku. Dokumenti i përbashkët është po ashtu, konfirmim i vullnetit tonë për të forcuar dhe thelluar marrëdhëniet me aleatet dhe me partnerët tanë të mëdhenjtë strategjik, SHBA dhe BE, si dhe i vullnetit tonë për t’u bërë përçues të një modeli të ri bashkëpunimi dhe zhvillimi për mbarë rajonin. Marrëveshjet po ashtu, që sapo u firmosën, shënojnë një cilësi krejt të re në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe hapin një kapitull të ri integritetit dhe modernizimit për të dy shtetet tona. Ekonomitë në të dy anët e kufirit, përmes kësaj deklarate dhe këtyre marrëveshjeve e hapave të paracaktuar në vijim, do të përfitojnë duke mos u ndërtuar vetëm mbi bazën e konkurrencës, padyshim, por dhe mbi bazën e përplotësimit e komple-

mentaritetit. Do të veçoja këtu mes të tjerash, edhe pse është e vështirë për të thënë kush është më e rëndësishme, kush është me pak e rëndësishme, - sepse konsiderojmë që të gjitha këto marrëveshje dhe ato që do të pasojnë në vijim janë komplementare dhe për këtë arsye të gjitha kanë rëndësinë e tyre, - marrëveshjen në fushën e energjisë. Duke e mbyllur, dua të theksoj që referenca që bëra në fjalën time hapëse të mbledhjes për vendet e BENELUX-it, mbetet për ne një referencë frymëzuese. Ne sot kemi bërë një mbledhje të parë të përbashkët, e cila do të pasohet nga një e dytë. Data mbetet për t’u përcaktuar nga Ministrat e Jashtëm, mes fundit të majit dhe fillimit të qershorit, në qytetin e Vlorës. Ku nga njëra anë do të bëhet një bilanc i punës së kryer deri atëherë, dhe nga ana tjetër do të përcaktohen hapat e mëtejshëm dhe kantieret e reja të punës së përbashkët që ne do të bëjmë. E pra, duke ju referuar vendeve të BENELUX-it kam pasur qartësisht parasysh domosdoshmërinë që ky bashkëpunim dhe kjo qasje të përbëjë dhe një shembull, por edhe një shtysë për të shkuar më tutje dhe për ta luajtur gjithnjë e më fort atë rol që Shqipëria dhe Kosova kanë pasur dhe kanë, rolin e shembujve të paqes, të stabilitetit dhe të bashkëpunimit ndër rajonal.

Ne jemi të vetëdijshëm se kjo kohë e re paqeje në rajon, ky vit i parë i hapur për rajonin tonë, pa fqinjë me pushkën drejtuar njëri – tjetrit, është një horizont i ri mundësish. Dhe ne së bashku, Shqipëria dhe Kosova, dy qeveritë tona, jemi të vendosur që të shkojmë përpara për t’i shfrytëzuar të gjitha këto mundësi. Nga ana tjetër, ne jemi krejtësisht të vendosur dhe vullnetmirë për të mirëpritur çdo ide, çdo sugjerim, çdo risi që do të vijë nga të gjitha nivelet e shoqërisë sonë. Historia apo rasti e sollën që të jemi ne sot të pranishëm që ta hapim këtë faqe, por ky bashkëpunim, kjo fazë e re, nuk është ekskluziviteti i dy qeverive. Dhe pavarësisht kundërshtive të natyrshme demokratike, politike që ne kemi, qoftë në Shqipëri, qoftë në Kosovë, ne jemi të vetëdijshëm që pjesë e këtij procesi është edhe opozita, bashkë me të gjithë ata që mendojnë ndryshe nga ne. Ashtu sikundër janë të gjitha nivelet e shoqërisë, sepse jemi të bindur që përtej të gjithë kundërshtive, ne ndajmë jo vetëm një gjuhë, por edhe një ëndërr, edhe një qëllim, edhe një vullnet të përbashkët për të bashkuar rrugët tona në rrugën e BE-së”.

Ministrja e Mbrojtjes, Kodheli, vizitë zyrtare në Kosovë

Ministrja Kodheli, i paraprin takimit të Prizrenit

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, me ftesë të ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) z. Agim Çeku zhvilloi në datën 10 janar 2014, një vizitë zyrtare në Prishtinë. Ministrja Kodheli fillimisht është prituri në një takim të veçantë nga homologu i saj, z. Agim Çeku. Ministri Çeku, pasi i uroi mirëseardhjen në Prishtinë znj. Kodheli dhe delegacionit që ajo kryeson, vlerësoi lart punën e saj në krye të ministrisë së Mbrojtjes. Nga ana e saj ministrja Kodheli falënderoi z. Çeku për pritjen e ngrohtë që i rezervoi, duke nënvizuar se bashkëpunimi mes dy vendeve tona do të intensifikohet akoma më tej dhe oguri më i mirë është mbledhja e përbashkët e dy qeverive. Në fund të këtij takimi, dy ministrat dhanë një konferencë për shtyp, ku u ndalën tek bashkëpunimi bilateral, rajonal dhe më gjerë. Më pas, agjenda e vizitës së ministres së Mbrojtjes të Shqipërisë në Prishtinë ka vijuar me takimin me kreun e Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi. Të dy zyrtarët e lartë diskutuan për çështje të rëndësishme mes dy vendeve tona, duke e vënë theksin tek rëndësia që ka unifikimi i terminologjisë mes nesh. Në vijim, znj. Kodheli është prituri nga presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga. Presidentja e Kosovës e falënderoi znj. Kodheli për angazhimin e saj për të intensifikuar marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve. Znj. Jahjaga e ftoi ministren Kodheli që të bëjë gjithçka është e mundur për të shtuar prezencën e femrës në Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Nga ana e saj, znj. Kodheli theksoi se mbetet e vendosur që përfaqësimin femëror ta çojë deri në nivelet më të larta drejtuese të FA. Gjithashtu ajo shprehu gatishmërinë e qeverisë së Shqipërisë për të ndihmuar në përfshirjen e Kosovës në iniciativat rajonale dhe ato ndërkombëtare të sigurisë, si dhe për shkëmbim të përvojave në procesin e integritet të Kosovës në NATO. Një takim të veçantë për ministren e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli, ka rezervuar kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi. Ministria Kodheli garanoi kryeministrin Thaçi për mbështetjen e padiskutueshme të qeverisë shqiptare në të gjitha nismat e qeverisë dhe shtetit të Kosovës. Në këtë kuadër, kryeministri i Kosovës, z. Thaçi tha se mbledhja mes dy qeverive është një hap i madh përpara, i cili nuk do të mund të ndalet nga askush në të ardhmen. Në të gjitha këto takime të rëndësishme spikati fryma e ngrohtë dhe vëllazërore e bashkëpunimit midis dy vendeve tona.



Kodheli: Shqipëria do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën dhe FSK-në

Ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, Kodheli vizitoi Ministrinë për FSK-në

Në ambientet e Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës, në datën 10 janar 2014, qëndroi për një vizitë zyrtare ministrja e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli, e cila u prit me nderime të larta nga Toga e Nderit dhe Orkestra Frymore e FSK-së. Të dy ministrat, fillimisht biseduan kokë më kokë, për të vazhduar më pastaj takimin e përbashkët në nivelin e zgjeruar të dy delegacioneve. Në takim morën pjesë edhe komandanti i FSK-së, gjeneraljtënant Kadri Kastrati, komandanti i Forcave Tokësore gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët: Zymer Halimi, Bashkim Jashari, Gëzim Hazrolli dhe Enver Cikaqi, sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj dhe kolonel Hasan Hoxha, ushtrues i detyrës së Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim, ndërsa në delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë, merrnin pjesë: Islam Lauka, ambasador i Shqipërisë në Kosovë, Gjergj Teneqexhiu drejtor i kabinetit, Edlira Prendi këshilltare për shtyp, Arian Zaimi këshilltar ushtarak dhe kolonel Fiqri Hoxha, atashë ushtarak. Ministri i FSK-së, Agim Çeku pasi i ka dëshiruar mirëseardhje dhe i ka uruar detyrën e re, ministres Kodheli, e ka falënderuar atë dhe Ministrinë e Mbrojtjes për ndihmat që kanë dhënë dhe po japin për FSK-së. Ministri Çeku, gjatë takimit e ka njoftuar gjerësisht ministren e Mbrojtjes, znj. Kodheli, për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, shkollimin, trajnimet, bashkëpunimin si dhe për planin e zhvillimit në të ardhmen. Pas takimit të përbashkët në nivel të dy delegacioneve, të dy

ministrat mbajtën një konferencë të përbashkët me gazetarë. Me këtë rast, ministri i MFSK-së, Agim Çeku, tha se: "FSK-ja është një tregim i suksesshëm në Kosovë, është institucioni më i besuar nga qytetarët e Kosovës, është institucioni i afirmuar profesional, i besueshëm, i trajtuar si partner nga faktori ndërkombëtar dhe thjeshtë është edhe i pranuar edhe nga ana e NATO-s, si një institucion që i ka ngritur dhe i ka të gjitha kapacitetet veta. Të gjitha sukseset që kemi arritur, një pjesë të rëndësishme të kontributit ka edhe Shqipëria dhe Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë, që na kanë ndihmuar, që ne sot, të deklarojmë që jemi institucion i suksesshëm. Biseduam edhe për projektet konkrete në të ardhmen, në këtë drejtim dhe e informuam ministren Kodheli, për të arriturat e FSK-së, sot dhe ku do të jemi nesër." Ndërsa, ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Kodheli falënderoi ministrin Çeku, dhe shtoi se: "Kjo vizitë është një kënaqësi e veçantë për mua. Unë në të njëjtën kohë e informova ministrin Çeku, për të gjitha zhvillimet e fundit të Forcave tona të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes." Në fund, ministrja Kodheli shtoi: "Me ministrin Çeku, ndamë mendimin e njëjtë, për nivelin e bashkëpunimit që kemi midis FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ne të dy palët do të gjëmë rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit akoma më të lartë. Ne jemi këtu për ta mbështetur këtë proces në mënyrë që me ndihmën e aleatëve tanë strategjikë dhe të SHBA-s, Shqipëria do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën dhe FSK-në, drejt integritet në NATO dhe Bashkim Evropian."

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi priti në takim ministren e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Mimi Kodheli

Synohet zgjerim bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi priti në Prishtinë, në datën 10 janar 2014, ministren e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Mimi Kodheli, me të cilën bisedoi për zhvillimet aktuale politike në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe për bashkëpunimin mes dy vendeve. Kryeministri Thaçi dhe ministrja Kodheli, theksuan nevojën e thellimit të bashkëpunimit në mes vendeve tona, si dy shtete të pavarura, me orientim të qartë evropian dhe euroatlantik. "Përvoja e Shqipërisë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në NATO, është e një rëndësie të veçantë edhe për Republikën e Kosovës", - tha

Kryeministri Thaçi. Ai falënderoi ministren Kodheli për mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në funksion të arritjes së standardeve më të larta të NATO-s për FSK-në. Nga ana tjetër, ministrja e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, falënderoi kryeministrin Thaçi për lidhshirësinë e treguar në proceset më të rëndësishme historike për Kosovën dhe shprehu gatishmërinë që në të ardhmen të dy shtetet, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës të zgjerojnë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, priti në takim ministren e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, Mimi Kodheli

Shqipëria, përkushtim për thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit

Presidentja Jahjaga vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë dhe theksoi nevojën e thellimit të këtij bashkëpunimi në të gjitha fushat, në veçanti në procesin e integritet evropian. Presidentja Jahjaga tha se Kosova ka shënuar përparime të theksuara në konsolidimin e shtetësisë, në krijimin e shtetit ligjor dhe gjithëpërfshirës, si dhe në normalizimin e marrëdhënieve me shtetet fqinje, në veçanti me Republikën e Serbisë. Ajo tha se integrimi i Kosovës në strukturat euroatlantike është përparësi e institucioneve të vendit dhe theksoi se ndërtimi i marrëdhënieve kontraktuale me NATO-n, përmes Partneritetit për Paqe, do të ndihmonte edhe në ruajtjen e stabilitetit të vendit dhe gjithë rajonit. Presidentja Jahjaga tha se: "Shqipëria mund ta ndihmojë Kosovën në arritjen e standardeve dhe përbashkëpunimit e kriterëve të përcaktuara nga Aleanca atlantiko-veriore." Ajo tha ndër të tjera se: "Arritjet e FSK-së vitin e kaluar kanë marrë një dimension të ri dhe një trajtë konkrete të suksesit, me zyrtarizimin e vendimit të NATO-s për të deklaruar kapacitetet e plota të FSK-së." Ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, Mimi Kodheli vlerësoi përparimin e arritur në Kosovë dhe theksoi përkushtimin e qeverisë së Shqipërisë për thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit midis dy vendeve. Ministrja Kodheli shprehu gatishmërinë e Qeverisë së Shqipërisë për të ndihmuar në përfshirjen e Kosovës në iniciativat rajonale dhe ato ndërkombëtare të sigurisë, si dhe për shkëmbim të përvojave në procesin e integritet të Kosovës në NATO.



Ministrja e Mbrojtjes, Kodheli, zhvilloi një vizitë zyrtare në Greqi

Premtohet një bashkëpunim greko-shqiptar i ndryshëm dhe i ri në fushën e Mbrojtjes

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, zhvilloi një vizitë zyrtare dy ditore në Athinë, në datat 14-15 janar 2014, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes së Greqisë, z. Dimitris Avramopoulos. Në nisje të kësaj vizite, ministrja Kodheli është pritur në një takim të veçantë nga kryeministri i Republikës së Greqisë, z. Antonis Samaras. Z. Samaras i uroi mirëseardhjen znj. Kodheli dhe e uroi për detyrën e saj si ministre e Mbrojtjes së Shqipërisë. “Të jesh ministre Mbrojtje femër do të thotë shumë dhe ky është një mesazh shumë i fortë”, u shpreh kryeministri grek. Në vijim të bisedës, kreu i qeverisë greke tha se: “Shqipëria po kalon një tranzicion pushteti, por po strukturohet fuqishëm dhe ne na keni në krah që t’ju ndihmojmë, veçanërisht Ministrinë e Mbrojtjes dhe ju zonja Kodheli.”

“Ne dëshirojmë që të rishikojmë dhe të forcojmë më tej të gjitha marrëveshjet mes nesh”, - iu drejtua z. Samaras ministres shqiptare të Mbrojtjes. Sipas kryeministrit Samaras, gjërat kanë ndryshuar në favor të përbashkët. “Ne kaluam një periudhë të vështirë, por tashmë po rimëkëmbim ekonominë dhe jemi të sigurt në një të ardhme më të mirë” - tha ai ndër të tjera. Nga ana e saj, zonja Kodheli e falënderoi kryeministrin Samaras për pritjen e veçantë dhe tejet të ngrohtë dhe i transmetoi përshëndetjet e kryeministrit Rama dhe të popullit shqiptar. Ministrja Kodheli e njohu z. Samaras me reformat e ndërmarra në institucionin që ajo drejton, duke u ndalur te lufta kundër korrupsionit, reformën në Forcat e Armatosura etj. Znj. Kodheli e uroi z. Samaras edhe për presidencën e BE dhe u shpreh se: “Shqipëria shpreson të marrë statusin e vendit kandidat në gjashtëmuorin e parë të 2014. Në këtë pikë ne kemi nevojë për mbështetjen tuaj”. Kryeministri Samaras dha mbështetje të plotë për Shqipërinë në aspiratën e saj evropiane. Ai u shpreh i bindur se nën drejtimin e kryeministrit Rama, të cilin e cilësoi mik dhe një njeri solid, Shqipërinë e pret një perspektivë e qartë evropiane. Në vijim të vizitës së saj, ministrja e Mbrojtjes Kodheli vendosi një kurorë në monumentin e Usharit të Panjohur në sheshin Sintagma në Athinë.

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli takon presidentin e Greqisë, Karolos Papulias

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli në mbyllje të vizitës së saj dy



ditore në Greqi, në datat 14-15 janar 2014, është pritur në një takim të veçantë nga presidenti Karolos Papulias. Takimi u zhvillua në një atmosferë mjaft të ngrohtë dhe miqësore. Bashkëbiseduesit vlerësuan marrëdhëniet e bashkëpunimit midis dy vendeve tona, si dy vende fqinj nga më të vjetrit në rajon, me lidhje të vjetra historike dhe tradicionale. Në mënyrë të veçantë ata ndanë të njëjtin mendim për zhvillimet pozitive të kohëve të fundit që po i japin marrëdhëniet tona një përmbajtje të re cilësore në interes të dy popujve tanë, të stabilitetit dhe paqes në rajon, si një vlerë e shtuar edhe në kuadrin e të gjithë Bashkimit Evropian. Si presidenti Papulias, ashtu edhe ministrja Kodheli, gjatë bisedës së tyre, prekën edhe disa nga çështjet e agjendës së marrëdhënies dypalëshe që kërkojnë

zgjidhje në frymën e klimës pozitive dhe vullnetit të mirë të dy qeverive tona, siç janë ligji i luftës, de-limitimi i detit, nderimi i të rënëve në Luftën Antifashiste, toponimet etj. Ministrja Kodheli vuri në dijeni presidentin Papulias mbi zhvillimet e fundit në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës, mbi mbledhjen e fundit mes dy qeverive, duke e konsideruar atë si një model i mirë që mund të bëhet mes qeverive të tjera të rajonit tonë. Presidenti Papulias vlerësoi vendosmërinë e qeverisë Rama për reformat brenda vendit dhe vendosmërinë e saj për t’u bërë anëtarë e familjes evropiane. Shqipëria, tha ai, është një vend evropian, i takon Evropës dhe Greqia ka qenë dhe mbetet mbështetësja kryesore për integrimin e shpejtë të saj në BE, në periudhën e presidencës së saj.

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli pritet nga homologu i saj Avramopoulos

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli në vijim të vizitës së saj dy ditore në Greqi zhvilloi një takim me homologun e saj, ministrin grek të Mbrojtjes, z. Dimitris Avramopoulos. Në këtë takim u diskutua me tone entuziaste për bashkëpunimin mes dy vendeve tona në fusha të rëndësishme dhe me impakt të madh për qytetarët e të dy vendeve. Temat e diskutuara në këtë takim kishin të bënin me bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, si dhe mbështetjen e padiskutueshme në rrugën e Shqipërisë drejt BE. Të dy palët ndanë të njëjtin mendim që takimi i sotëm i jep një dimension të ri bashkëpunimit mes dy vendeve tona. Ashtu si kryeministri Samaras, edhe ministri Avramopoulos, shprehu bindjen

se nën drejtimin e qeverisë Rama e ardhmja e Shqipërisë është e sigurt. “Është një politikan modern dhe largpamës, është fat për Shqipërinë që ka një politikan të tillë, që i mbishton vlerat e vendit”, - u shpreh Avramopoulos për kryeministrin Rama. Më pas axhenda e znj. Kodheli vijoi me një takim kokë me kokë me homologun e saj dhe në fund të takimit dhanë së bashku një deklaratë për shtyp. Në deklaratën për mediet, z. Avramopoulos u kujdes të theksojë se ky është një kapitull i ri në bashkëpunimin dypalësh. Sipas tij, bashkëpunimi do të jetë shumë i vlefshëm për ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ku Greqia do të ofrojë të gjithë mbështetjen e saj. “Ky takim është një mesazh paqeje dhe stabiliteti në rajon dhe më gjerë në funksion të fqinjësisë së mirë. Ne do ju mbështesim fuqishëm në rrugën tuaj drejt anëtarësimit në BE”, - tha ministri grek i Mbrojtjes. Ndërsa ministrja Kodheli, ndër të tjera, theksoi se “Me ministrin Avramopoulos ndamë të njëjtin qëndrim mbi mundësinë për të thelluar më tej marrëdhëniet tona në fushën e mbrojtjes, për ta bërë atë më produktive për Forcat tona të Armatosura”. Ajo e falënderoi homologun e saj në emër të qeverisë shqiptare për mbështetjen e padiskutueshme që i jep Shqipërisë drejt BE. Më herët, në nder të vizitës së saj në Athinë, znj. Kodheli është nderuar me një ceremoni tejet të veçantë, e para e këtij lloji për një ministër shqiptar, në sheshin Sintagma, ku ajo vendosi një kurorë në monumentin e Usharit të Panjohur.



Deklaratat për media nga ministri i Mbrojtjes së Greqisë, z. Avramopoulos dhe nga ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Kodheli

Avramopoulos: Shqipëria zë një vend të veçantë, jo vetëm në Evropën Juglindore, por në Evropë



Unë sot pata nderin dhe kënaqësinë e veçantë të mirëpres këtu, në Ministrinë e Mbrojtjes, homologen dhe miken time, znj. Mimi Kodheli, ministre e Mbrojtjes e Shqipërisë. Greqia dhe Shqipëria, siç edhe dihet, janë dy vende fqinjë që kanë lidhje të forta historike e që datojnë mijëra vjet më parë. Grekët dhe shqiptarët kanë jetuar në paqe me njëri-tjetrin qysh prej lashtësisë. Ata jetojnë edhe sot me njëri-tjetrin përmes pranisë së minoritetit grek në Shqipëri, si edhe përmes qindra mijëra shqiptarëve që jetojnë, punojnë dhe zhvillojnë mirëqenien e tyre në Greqi. Marrëdhëniet tona bazohen kryesisht në respektin reciprok, miqësinë dhe solidaritetin. Të dyja qeveritë, si e jona, ashtu edhe qeveria e re shqiptare, dëshirojnë të forcojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin në të gjitha fushat.

Ministre dhe mike ime e dashur,

vizita juaj e sotme në Athinë është shumë e rëndësishme dhe shënon një fillim të ri; gjithashtu ajo inauguron një kapitull të ri bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve tona në fushën e Mbrojtjes. Sot patëm rastin t'ju prezantonim një "briefing" mbi sistemin grek të mbrojtjes dhe t'ju shpjegonim se është një nga sistemet e mbrojtjes më të mirë e më të besueshëm në Evropë. Qëllimi ynë, kauza primare së cilës ne duhet t'i shërbejmë, është integriteti dhe pavarësia e vendit tonë. Por në të njëjtën kohë, ne përthithim edhe mesazhet e kohës sonë. Ne jemi të dy vende anëtare të NATO, të vendosura të promovojmë paqen, stabilitetin, bashkëpunimin dhe miqësinë jo vetëm përbrenda marrëdhënies sonë dypalëshe, por edhe në rajon. Në këtë frymë, sot, vendosëm të hapim një kapitull të ri në marrëdhënien tonë dypalëshe në fushën e Mbrojtjes. Gjatë bisedimeve që patëm pak më parë, kërkuam dhe shqyrtuam të gjitha mënyrat e mundshme për të përforcuar më tej bashkëpunimin dypalësh. Ne kemi eksperiencën, "know-how", infrastrukturën dhe besojmë që bashkëpunimi ndërmjet nesh do të jetë shumë i dobishëm për sistemin e mbrojtjes të Shqipërisë, veçanërisht në momentin kur ju keni përgatitur dhe po aplikoni një plan të ri riorganizimi për Forcat e Armatosura shqiptare. Ky është mesazhi që ne duam t'u përcjellim të gjithëve sot. Është një mesazh paqe dhe stabi-

liteti për rajonin tonë, Evropën Juglindore dhe gjithë Ballkanin, por edhe një mesazh i vendosmërisë sonë për të bashkëpunuar më ngushtë dhe për të thelluar, zgjeruar dhe forcuar marrëdhëniet tona dypalëshe në fushën e Mbrojtjes, dhe jo vetëm. Së fundi, do të doja t'ju falënderoj juve personalisht dhe delegacionin që ju shoqëron për bisedimet vërtet të dobishme dhe të frytshme që zhvilluam sot. Biseduam me njëri-tjetrin me ndershmëri dhe besim. Jam i sigurt se këto dy principe janë shumë të rëndësishme në marrëdhëniet mes dy shteteve, por edhe më të rëndësishme në marrëdhëniet mes dy popujve fqinjë, të cilët kanë kaluar shumë situata të vështira në të kaluarën, por tani ne jemi të bashkuar nga perspektiva jonë e përbashkët evropiane. Edhe një herë, me rastin e vizitës së znj. Kodheli, do të doja të shpreh mbështetjen e plotë të vendit tonë drejt rrugës evropiane, drejt perspektivës evropiane të Shqipërisë. Uroj që ftesa për të nisur sa më shpejt që të jetë e mundur bisedimet t'i dërgohet së shpejti Shqipërisë. Shqipëria zë një vend të veçantë, jo vetëm në rajonin e gjerë të Evropës Juglindore, por në Evropë në përgjithësi, ku ne do të takohemi për të vijuar rrugën tonë të përbashkët. Unë jam i bindur se forcimi i marrëdhënieve tona dypalëshe dhe kontaktet hapin perspektiva të reja për sigurinë dhe prosperitetin e jo vetëm popujve të vendeve tona, por edhe më gjerë për popujt e rajonit të Europës Juglindore.

Ministrja, mike ime e dashur, Mimi Kodheli,

Ju ftoj edhe një herë në Athinë. Faleminderit për bashkëpunimin e veçantë që ne nisëm disa muaj më parë, kryesisht pas vizitës sime në Shqipëri, teksa shoqëroja presidentin e Republikës helene, z. Papoulias, dhe për domethënien që i kemi dhënë kuadrin të bashkëpunimit tonë. Së shpejti do të takohemi përsëri, shpresoj në fund të muajit gusht, për të përditësuar dhe përmirësuar bashkëpunimin tonë të vjetër në fushën e Mbrojtjes mes dy vendeve tona dhe siç patëm mundësinë të biem dakord sot, do të vijojmë me nënshkrimin e një bashkëpunimi të ri. Gjithashtu, ky nënshkrim do të jetë vula që do të ratifikojë dhe konfirmojë vendimet që morëm sot dhe kryesisht, ajo do të hapë një perspektivë të re të marrëdhënieve tona dypalëshe në fushën e Mbrojtjes.

Kodheli: Nënvizuam rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit në të ardhmen



Z. Avramopoulos, do të doja t'ju falënderoj për pritjen tuaj të përzemërt dhe për bisedimet e dobishme që sapo përfunduam. Ndonëse është hera e parë që vizitoj zyrtarisht Athinën, kam pasur kënaqësinë të takoj kolegun tim, z. Avramopoulos në Bruksel gjatë takimit të ministrave të Mbrojtjes, si dhe në Tiranë nëntorin e kaluar. Gjithashtu, kam pasur kënaqësinë të takoj zj. Gennimata tetorin e kaluar në Slloveni. Kjo tregon qartazi rëndësinë që vendet tona i kushtojnë bashkëpunimit dypalësh. Po kështu, do të doja t'i referohem takimeve intensive të nivelit të lartë për bashkëpunimin dypalësh, veçanërisht pas marrjes së detyrës së qeverisë së re të Shqipërisë, që tregon se Greqia mbetet një partner i rëndësishëm për Shqipërinë. Meqë kjo vizitë zhvillohet menjëherë pas marrjes së Presidencës të Bashkimit Evropian nga ana e Greqisë, dëshiroj, me këtë rast, t'i uroj qeverisë greke një presidencë të suksesshme, si dhe dëshiroj të shpreh mirënjohjen tonë për mbështetjen që ajo ka dhënë dhe na jep në përpjekjen e Shqipërisë për t'ju bashkuar BE. Gjatë takimit me ministrin Avramopoulos, patëm mundësinë të diskutonim disa çështje të bashkëpunimit dypalësh në fushën e Mbrojtjes, mes të cilave do të doja t'i referohem trajnimit të forcave tona, pjesëmarrja në stërvitje të përbashkëta në kuadër të NATO, si edhe në stërvitje dypalëshe,

pjesëmarrja e forcave tona në stërvitje NMIOTC, pjesëmarrja e oficerëve grekë në shkollat shqiptare dhe mësimi i gjuhës greke nga oficerët shqiptarë. Bashkë me z. Avramopoulos, nënvizuam rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura. Jam e kënaqur t'ju bëjë me dije se 35 studentë shqiptarë studiojnë në akademitë e larta ushtarake në Greqi dhe se dy oficerë grekë kanë përfunduar Akademinë e lartë të Mbrojtjes dhe Sigurisë në Shqipëri. Unë besoj që kjo tendencë do të ruhet në të ardhmen, përtej bashkëpunimit tonë si vende anëtare të NATO, në kuadrin e iniciativave rajonale, siç është ajo e Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore, e cila do të vendoset në Greqi deri në vitin 2017. Ne angazhohemi të vazhdojmë bashkëpunimin me Greqinë në të ardhmen dhe kjo është arsyeja pse unë ndodhem këtu. Unë vlerësoj në veçanti faktin se z. Avramopoulos, në të gjitha takimet u duk i gatshëm për të ndihmuar gjithmonë dhe kurdoherë Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Kjo është ajo çka ai ka ofruar deri më tani, në çdo qëndrim që ai ka mbajtur. Ai është mik i çmuar dhe mbështetës i Shqipërisë dhe shpresoj të kem gjetur fjalët e duhura për të shprehur mirënjohjen time të thellë për çdo gjë që ai ka bërë dhe po bën, për gjithçka që ai ka dhënë dhe jep si ministër i Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë.

Shumë faleminderit mik dhe koleg i dashur

MENDIMI USHTARAK

PËR FORCAT E

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Për të krijuar Forcat e Armatosur, në rrethanat e atëhershme, Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe Ismail Qemalit i duhej një strategji. Strategjia ishte e thjeshtë. Siç del nga dokumentacioni i kohës, i Qeverisë së Vlorës, sipas kësaj strategjie, fillimisht, në fazën e parë synonte mbrojtjen e vendit nga copëtimi. Në planin e brendshëm vendi vuante e përjetonte vështirësi të rënda ekonomike, shoqërore, politiko-ushtarake, si dhe të pasigurisë publike, që ishin rrjedhojë e mungesës së shtetit me institucionet e tij. Në këto rrethana vendit dhe popullit shqiptar i duhej të mbrohej për të mbijetuar ndaj lakmisë dhe pushtimit të shteteve fqinje, por dhe për të vendosur rregullin, qetësinë e rendin mbi anarkinë dhe mungesat e shumta. Shtetit të ri i duhej të krijonte institucionet e tij, midis të cilave dhe Forcat e Armatosura. Qeveria mori masa për të mbrojtur vendin me ato pak forca që kishte në dispozicion. Ismail Qemali urdhëroi të krijohet një forcë e vogël e armatosur, e cila mori për detyrë të mbronte bregdetin e Vlorës dhe të mbyllte drejtimin Himarë-Vlorë, duke u vendosur në Qafën e Llogorasë. Për të krijuar këtë Forcë të Armatosur, në rrethanat e atëhershme, Qeverisë së Përkohshme të Vlorës u duhej një strategji. Ajo mbështetej në një vizion dhe mendim ushtarak për kohën. Strategjia ishte e thjeshtë. Siç del nga dokumentacioni i kohës, i Qeverisë së Vlorës, sipas kësaj strategjie, fillimisht, në fazën e parë synonte mbrojtjen e vendit nga copëtimi. Forcat e Armatosura dhe Ushtria Shqiptare duhej të krijoheshin sa më shpejt që të ishte e mundur. Për këtë qëllim do shfrytëzoheshin pjesët e efektivave dhe të strukturave ekzistuese ushtarake ende në përbërje të njësive ushtarake turke që vepronin në Shqipëri, ende në atë kohë. Ishte e kuptueshme se këto forca do bazoheshin tek ushtarakët me origjinë shqiptare të çdo krahine. Shumica e tyre bënin pjesë në strukturat rezerviste dhe aktive. Pjesa tjetër, ajo e angazhuar në luftime, ishin vullnetarë popullorë të krahinave të ndryshme shqiptare. Ndërkohë nevoja e ngutshme për të krijuar një forcë të organizuar ushtarakisht e detyroi Qeverinë e Vlorës të hynte fillimisht në bisedime me komandën e ushtrisë turke në Berat, me qëllim që të siguronte armë për forcat shqiptare. Kjo strategji dallohet qartë në letrën që Ismail Qemali i dërgonte prefektit të Beratit, më 9 dhjetor 1912, ku i shkruan: "...Qëllimi ynë kryesor është si ta shpëtojmë atdheun nga kthetrat e armikut, të ruajmë nga rreziku i shfarosjes tepricat e ushtrisë dhe ta forcojmë atë për t'u përlëshur me armikun. Kjo është për ne një çështje jetësore, njëkohësisht një detyrë e shenjtë për shefat e armatave ..." dhe më poshtë vazhdon: "... merrni masat që t'u sigurohen ushtarakëve nevojat në këtë kohë krize dhe të mbahet qetësia". Kjo ishte një detyrë e vështirë, po të kihet parasysh shthurja e përgjithshme e ushtrisë turke dhe sidomos fakti që, pas shpalljes së Pavarësisë,

”



Në kuadrin e 170 vjetorit të lindjes dhe 95 vjetorit të vdekjes së Ismail Qemalit

ushtarët shqiptarë që shërbenin në ushtrinë turke e konsideronin të huaj vazhdimin e shërbimit nën flamurin e Turqisë. Ata filluan të dezertorin në masë nga radhët e ushtrisë turke, sidomos nga divizioni i Janinës, për t'a mbrojtur atë nga pushtimi grek. Strategjia për krijimin e Forcave të Armatosura nisi të vihej në zbatim menjëherë me krijimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe me formimin e dikasterit të Luftës (Mbrojtjes). Kuvendi Kombëtar i Vlorës në mbledhjen e tij të parë, më 4 dhjetor 1912, zgjodhi "Grupin ekzekutiv të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës", të cilin edhe e ligjëroi, duke e dekretuar dhe duke e bërë të njohur për tërë vendin. Në përbërje të kësaj Qeverie përfshihej edhe një dikaster mjaft i rëndësishëm, ai me emërtimin Ministria e Luftës (e Mbrojtjes), i cili ishte edhe hallka kryesore organizative dhe drejtuese e Forcave të Armatosura Shqiptare. Ky vendim bëhej i njohur në aktin e kohës të Kuvendit, ku shkruhej: "Në përbërje të këtij grupi bënte pjesë edhe dikasteri i rëndësishëm i Luftës (i Mbrojtjes Kombëtare) i kryesuar nga Mehmet Pashë Dërralla (Tetova)", gjeneral karriere dhe komandant i shquar i kryengritjeve shqiptare të viteve 1909-1911. Ky dikaster, në bashkëpunim me dikasterin e Punëve të Brendshme, morën masa për mbrojtjen e trojeve shqiptare, ruajtjen e rendit brenda vendit dhe për këtë nisën punën për të organizuar strukturat përbërëse të Forcave të Armatosura shqiptare. Sipas vizionit, strategjisë dhe skemës së përpunuar nga drejtuesit dhe shtabet ushtarake të dikastereve të mësipërme, krijimi dhe



organizimi i forcave u krye në dy faza. Në fillim u formua dhe u organizua Ministria e Luftës, Shtabi Madhor dhe Ministria e Punëve të Brendshme me strukturat më të mundshme ushtarake si ato vullnetare, rezerviste dhe xhandarmëria e policia, në periudhën relativisht të shkurtër nga nëntori 1912 deri në qershor 1913. Faza tjetër filloi në fillim të qershorit 1913 dhe vijoi deri më 22 janar 1914, kur Qeveria e Përkohshme e Vlorës pushoi së vepruari dhe u largua nga skena politike shqiptare. Në fazën e dytë u formua Zyra e Shtabit Madhor dhe u riorganizua struktura e Xhandarmërisë. Po në këtë kohë nisi edhe organizimi i forcave aktive. Pra, vetë përshkallëzimi i organizimit të Forcave të Armatosura, të organizmave drejtuese dhe strukturave përbërëse të tyre, dëshmon për një njohje të thellë të gjendjes reale të mundësive ushtarake të Shqipërisë së asaj kohe. Siç u theksua më lart, së pari, në fazën e parë në përbërje të Forcave të Armatosura u përfshinë forcat rezerviste me origjinë shqiptare, që përbëheshin në masë nga ushtarakë të moshës 40-60 vjeç, të cilët thirreshin me terminologjinë ushtarake turke "redifë" ose "muftafizë". Formacionet rezerviste ishin reparte të rregullta, të pajisura me armatime e municione të lehta, të veshur me uniforma ushtarake të ushtrisë së rregullt, kur thirreshin në luftë. Këto reparte ishin të organizuara, të disiplinuar dhe, ç'është më kryesorja, më të përgatitur ushtarakisht, pasi ishin stërvitur sipas normave dhe kërkesave klasike ushtarake. Ata njihnin dhe dinin të zbatonin gjatë gjithë veprimtarive luftarake taktikën e luftës me front të

rregullt. Këto ishin formacione me bazë batalioni, që vepronin atë kohë në disa krahina të vendit, në Skrapar, Berat, Vlorë, Tepelenë, Delvinë etj., por edhe në Shqipërinë e Mesme e të Veriut, ku u përdorën me mjaft efektivitet. Forcat rezerviste përbënin një masë të konsiderueshme të Ushtrisë Shqiptare. Struktura tjetër përbërëse, edhe kjo masive, ishin forcat vullnetare, të cilat në fillimet e Qeverisë së Vlorës ishin mjaft aktive. Ato ishin të organizuara në formacione të thjeshta, tradicionale, në bazë çetash të fshatrave ose të lagjeve të qytetit, me një prijës të njohur në krye dhe vepronin sipas taktikës tradicionale. Deri në qershor 1913 numri i tyre u rrit mjaft. Strukturë parësore e Forcave të Armatosura shqiptare ishte Xhandarmëria. Ajo nisi të krijohet qysh në fillimet e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe u shtri deri në maj 1913. Kjo strukturë u vlerësua me shumë seriozitet nga Qeveria dhe Ministria e Luftës si dhe ajo e Brendshme, sepse ishte një forcë që merrej kryesisht me sigurimin e rendit dhe të qetësisë së brendshme, por edhe me mbrojtjen e vendit, krahas strukturave të tjera ushtarake. Dokumentet e Qeverisë së Vlorës dëshmojnë se të gjitha përpjekjet e bëra nga organet e saj dhe ministratë përkatëse, çuan në organizimin e një force që, deri nga fillimi i qershorit 1913, u shtri në mjaft zona ku njihej pushteti i kësaj qeverie. Madje, për organizimin e saj dhe të policisë e të drejtësisë të Qeverisë së Vlorës, u krijuan edhe disa komisione përkatëse. Sidoqoftë organizimi më cilësor i kësaj force do të niste pas qershorit 1913. Mbi përpjekjet e Qeverisë së Vlorës për organiz-

imin e Forcave të Armatosura mund të formohet një ide jo vetëm nga dokumentacioni vendas, por edhe nga një raport që i dërgonte Vjenës konsulli i Austro-Hungarisë pranë Qeverisë së Vlorës, Lejhanec, i cili ndiqte nga afër veprimtarinë e kësaj Qeverie. Lidhur me këtë ai raportonte: "...kohët e fundit Qeveria e Përkohshme është marrë me çështje organizative edhe po bën emërimet e shumta sidomos në fushën e administratës së brendshme...". Ministria e Luftës ose e Mbrojtjes Kombëtare, e cila, së bashku me pjesët përbërëse të saj, do të kryente edhe detyrën e Komandës së Përgjithshme të Fuqive të Armatosura, përbënte hallkën më të lartë organizuese e drejtuese të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Kjo ministri përbëhej nga "...zyra e Shtabit Madhor (Shtabit Madhor), zyrën qarkore, zyrën herrtare (logjistika) dhe zyrën shëndetësore...". Dikasteri i Luftës përgatiti dhe përpunoi konceptin dhe platformën e organizimit të ushtrisë dhe të strukturave përbërëse të saj në përputhje me gjendjen që ishte krijuar në Shqipëri. Struktura e saj ishte sanksionuar dhe përmbledhur në një rregullore shumë të vogël, e emërtuar "Rregullorja për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës", e cila u hartua më 22 prill 1913. Ajo ishte shumë e shkurtër, e përbërë nga 7 pika, dhe ishte e shkruar vetëm në një faqe. Në rregulloren shkruhej se deri në daljen e rregulloreve të reja ushtarake do të funksiononin rregulloret ekzistuese të ushtrisë turke. Qeveria udhëzoi Ministrinë e Luftës që për organizimin e një ushtrie të rregullt shqiptare të shikohej përvoja

K I ISMAIL QEMALIT

ARMATOSURA



ushtrimeve.

4. Komisioni i trajtimit të policisë e të xhandarmërisë.

5. Komisioni i ndërtimit”.

Konceptimi dhe formimi i këtij shtabi, ku vepronin një grup ushtarakësh mjaft të formuar, me kulturë profesionale ushtarake të nivelit akademik dhe me përvojë të lakmueshme luftërash, dëshmonte edhe për një kulturë të mirë politiko-ushtarake të drejtuesve të shtetit dhe të udhëheqësve ushtarakë shqiptarë të asaj kohe, të afirmuar nga Qeveria e Vlorës. Ky shtab, që varej nga Ministria e Luftës, shërbente edhe si një organ këshillimor për çështjet ushtarake pranë Qeverisë së Vlorës. Ngritjen e këtij shtabi të lartë ushtarak e bënte të njohur për qeverinë austro-hungareze në Vjenë, konsulli i saj në Vlorë, Lejhanec, që raportonte: “Në fillim të qershorit 1913 në Vlorë funksiononte një zyrë e Shtatmadhorisë, një lloj organi ushtarak i Qeverisë së Përkohshme”. Ky shtab, siç vërtetoi zhvillimi i ngjarjeve të kohës, luajti një rol të dukshëm në organizimin e zhvillimin e Forcave të Armatosura në fazën e dytë, siç ishte përmirësimi i strukturave të saj, veçanërisht të Xhandarmërisë dhe të forcave aktive. Kështu, për të organizuar mbi baza të shëndosha strukturën e forcave aktive të Ushtrisë, Ministria e Luftës dhe Shtabi Madhor urdhëruan krijimin e një kompanie të ashtuquajtur “Model”. Sipas shëmbëlltyrës së saj u krijua imazhi i kësaj strukture. Po në këtë fazë nisi edhe riorganizimi i xhandarmërisë e cila, veçanërisht pas qershorit, pati një përmirësim të dukshëm. Ky nivel u rrit më tej pas tetorit të po këtij viti, kur në Vlorë arriti grupi i oficerëve holandezë të kolonel De Weer-it dhe majorit Thomson, të cilët, sipas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të 29 korrikut 1913 në Londër, duhej të organizonin xhandarmërinë shqiptare. Eshhtë vendi të vihet në dukje se Qeveria e Vlorës dhe ushtarakët shqiptarë ndihmuan pa asnjë hezitim në punën e ushtarakëve holandezë për riorganizimin e Xhandarmërisë Shqiptare sipas koncepteve të përparuar të asaj kohe, për t’a bërë atë sa më efektive në veprimet e saj. Ajo u organizua tashmë mbi bazën e 4 detashmenteve, reparte këto të barabarta me një batalion, me 300 xhandarë secili. Çdo repart drejtohej nga një oficer shqiptar i shquar dhe me shumë përvojë. Të tillë ishin major Mustafa Aranitasi, kapiten Mustafa Maksuti (Shehu), kapiten Kasem Qafëzezi dhe kapiten Rexhep Shala. Koncepti i drejtë në krijimin e Forcave të Armatosura Shqiptare, u vërejt edhe në formimin e shërbimeve mbështetëse, siç ishin ai i Prapavija (6 maj 1913), i Mobilizimit (3 qershor 1913) dhe i Zbulimit ose Informativ (15 qershor 1913). Pa këto shërbime vështirë se

mund të kryenin veprimtarinë e tyre strukturat ose hallkat drejtuese të Forcave të Armatosura shqiptare. Ndërkohë, Qeveria e Vlorës, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Luftës dhe Shtabin Madhor, përcaktuan edhe vetë nivelin e të drejtës elektorale dhe politike të ushtarakut shqiptar. Në atë kohë ishte përcaktuar se përveç oficerëve, ushtarakët e tjerë nuk lejoheshin të merrnin pjesë në zgjedhjet, me qëllim që të mënjanoheshin ndikimi tyre nga politika. Një veprimtari sintezë, që evidentoi dhe afirmoi më së miri mendimin dhe vizionin ushtarak shqiptar për atë kohë, ishte pikërisht hartimi dhe publikimi i rregullores “Mbi organizimin e Milicisë Shqiptare”, që u miratua nga vetë Kryesia e Qeverisë së Përkohshme më 3 qershor 1913. Kjo rregullore u hartua me qëllim që të shpallte e të bënte të njohur projektin e Qeverisë së Vlorës për konceptin dhe mënyrën e organizimit të forcave ushtarake ekzistuese të vendit, deri sa të krijoheshin kushtet dhe mundësitë për krijimin e ushtrisë së rregullt. Kjo duket mjaft mirë nëse i referohemi vetë rregullores, ku parashikohet dhe përshkruhet qartë e saktë çdo gjë që lidhet me sistemin e organizimit ushtarak të përzgjedhur, sipas të cilit do të kryhej organizimi i fuqive ushtarake shqiptare deri në kohën e përcaktuar për krijimin e Ushtrisë së rregullt. Po kështu, në të përcaktohej edhe gjithçka tjetër për detyrimin ushtarak, moshën e të detyruarve për këtë shërbim, skemën e organizimit të brendshëm, detyrat luftarake, hierarkinë ushtarake, uniformën, armatimet, mënyrat e lajmërimit, vendvendosjen e reparteve e të nënreparteve sipas madhësisë së tyre, çështjet e administrimit dhe të rregullit dhe deri të trajtimi financiar i ushtarakëve të së gjithë niveleve. Rregullorja në të

vërtetë ishte një akt ligjor për nga përmbajtja, edhe për faktin se ajo u miratua nga vetë Qeveria e Vlorës, duke i dhënë asaj atributet dhe forcën ligjore. Njëherësh, hartimi i rregullores dëshmon qartë nivelin e lartë të dijeve dhe të kulturës profesionale ushtarake të anëtarëve të Shtabit Madhor shqiptar; prandaj miratimi i rregullores rriti prestigjin e këtij organi ushtarak jo vetëm në vend. Për këtë rregullore konsulli austro-hungarez në Vlorë do të shkruante: “Zyra (e Shtabi Madhor) hartoi rregulloren mbi funksionimin e milicisë shqiptare, sipas së cilës kjo e fundit duhej të ishte një forcë e organizuar, e ngritur mbi bazën e detyrimit ushtarak të përgjithshëm dhe që kishte për detyrë mbrojtjen e vendit deri sa të krijohesh një ushtri e rregullt”. Qeveria e Vlorës dhe kryetari i saj I. Qemali ditën të përzgjidhen e të përcaktojnë hallkat drejtuese në nivel strategjik, për Forcat e Armatosura që ishin në organizim e sipër, në shkallë vendi. Në këto kushte, deri sa të krijohesh Komanda e Përgjithshme, kjo detyrë iu ngarkua Ministrisë së Luftës. Por një dukuri që përshfaqti vizionin dhe konceptin modern të Qeverisë, madje dhe të udhëheqësve ushtarakë shqiptarë të viteve 1912-1913, ishte prirja dhe vendosmëria e tyre për organizimin e një Force të Armatosur me profil të tillë. Prandaj ata sugjeruan kryerjen më parë të studimit të disa sistemeve ushtarake evropiane. Ja si e përshkruan këtë vendim konsulli i cituar më lart, në një raport të tij: “...administrata ushtarake shqiptare kishte ndërmend të bënte më parë studime mbi sistemet e ndryshme ushtarake evropiane. Pastaj të vendoste të mbështetej në njërin prej tyre ose të krijonte një sistem të ri të vetin, që t’u përshtatej kushteve të shtetit të ri të pavarur”. Për të ilustruar këtë prirje,



mjafton të përmendim që të gjitha porositet e Qeverisë së Vlorës për armatime e municione për Forcat e Armatosura shqiptare u bënë në Austri, kurse ato për uniformat e reja, në Itali. Për këtë në librin “Pavarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha” thuhet: “Porosi të rëndësishme u bënë në arsenalet e Austro-Hungarisë, me gjithë ngushticën e madhe të mjeteve financiare.” Ndërsa ambasadori i Vjenës në Romë, Mereti, thotë: “...se në Ministrinë e Jashtme italiane kishte marrë vesh për ardhjen në Itali të disa përfaqësuesve të Qeverisë Vlorës për të blerë uniforma për xhandarmërinë shqiptare.” Së fundi duam të vëmë në dukje se është merita dhe vendosmëria e Qeverisë Shqiptare dhe e vetë I. Qemalit për t’u dhënë Forcave të Armatosura Shqiptare një karakter dhe përmbajtje sa më shumë që të ishte e mundur kombëtare. Kjo vendosmëri dhe prirje duket nëse i referohemi përzgjedhjes së drejtuesve ushtarakë kryesorë të Forcave të Armatosura: përzgjedhja e gjeneral Dërrallës në krye të Ministrisë së Luftës, e major Ali Shefqet Shkupit në krye të Shtabit Madhor, si dhe e oficerëve të shquar të asaj periudhe, Ismail Haki Tatzati, Mustafa Maksuti, Kasem Qafëzezi dhe Meleq Frashëri etj., që vinin nga trevat e ndryshme të vendit, në krye të formacioneve kryesore të Forcave të Armatosura shqiptare. Kjo dukuri shfaqet edhe më poshtë, në formacionet e tjera ushtarake, ku gjeje mjaft ushtarakë komandues edhe nga Kosova. Trevat shqiptare në vitet 1912-1913 edhe më tepër se deri atëherë u vlerësuan si faktor bashkimi dhe krenarie gjithëkombëtare. Madje, uniforma e këtyre forcave vlerësohej si e tillë. Kjo shfaqje tipike përshkruhet shumë qartë në revistën ZGJIMI, që botohej në Korçë, në numrin e 33-të të saj, ku botohej edhe një fotografi e tre ushtarakëve shqiptarë të viti 1913, në të cilën shkruhej: “Shikoni pakëz këtë fytyrë, e patë? Këto janë uniformat e ushtrisë shqiptare. Kjo është rroba e Kombit Shqiptar! Kjo është rroba që do të thotë se në këtë botë është një shtet që quhet Shqipëri!”. Kësisoj Ushtria Shqiptare vlerësohej në thelb si pasqyra e vetë kombit dhe e shtetit shqiptar. Nuk ka vlerësim dhe simbolikë më të qartë në këtë plan. Me gjithë përpjekjet për të krijuar një ushtri kombëtare të rregullt e bashkëkohore për shtetin e ri shqiptar, sipas përfytyrimit dhe përmasave të sotme, Qeveria e Vlorës nuk ia arriti dot qëllimit që i kishte vënë vetes, për shkak të mundësive të kufizuara materiale dhe kohës, pasi veprimtaria e saj u ndërpre. Megjithatë ajo hodhi bazat e para dhe shënoi fillimet e organizimit të Ushtrisë dhe të Forcave të Armatosura në vendin tonë. Ajo krijoi rreth 12000 forca, nga të cilat 4000-5000 ishin xhandarë. Në këto struktura u bashkuan dhe shërbyen rreth 70 oficerë dhe 150 nënoficerë të karrierës, që ishin shkolluar në Turqi. Kështu, vizioni dhe mendimi ushtarak i Qeverisë së Vlorës dhe i ushtarakëve që kishte përreth, me gjithë kufizimet e kohës, duhet të vlerësohen si një shërbim ndaj vendit dhe popullit shqiptar në tërësi dhe ndaj Forcave të Armatosura dhe artit ushtarak shqiptar në vecanti.

e ushtrive evropiane, që vërtetonte edhe njëherë vizionin e qartë mbi krijimin e saj dhe se ishte e interesuar për krijimin e një ushtrie të kohës. Në fazën pasuese, e cila nisi në qershor dhe vijoi deri nga dhjetori i vitit 1913, sipas strategjisë së I. Qemalit dhe Qeverisë së Vlorës, u kalua në një nivel më cilësor të organizimit dhe të përgatitjes së Forcave të Armatosura, të strukturave të veçanta, si dhe në hallkat drejtuese e në veprimtarinë e tyre. Pikërisht në maj 1913, në përputhje me parashikimet e Qeverisë dhe të Ministrisë së Luftës dhe si nevojë e një hallke të qendërzuara, që do të shërbente për organizimin, përgatitjen, bashkërendimin dhe drejtimin profesional të veprimeve luftarake të Forcave të Armatosura, u formua Shtabi Madhor apo Shtati Madhuer, siç quhej në terminologjinë autentike të kohës. Ky Shtab, që ishte konceptuar shumë i thjeshtë dhe tepër racional në ndërtim, vetëm me 5 zyra, do t’i jepte një hop organizimit të Forcave të Armatosura, por ai në të vërtetë u mor me gjithçka që kishte të bënte me veprimet luftarake, me furnizimet etj. në frontet e luftimeve në Jug, në Shqipërinë e Mesme apo edhe në atë të Veriut. Për këtë tregues dëshmojnë qarkoret e hartuara e të dërguara nga ky shtab me firmën e Kryetarit të tij, major Ali Shefqet Shkupit, në lidhje me problemet e përmendura më sipër. Elementet përbërëse të shtabit, të përcaktuara në “Rregulloren e përkohshme të Ministrisë së Luftës” të 22 prillit 1913, ishin:

1. Qarqet e Shtatit Madhuer.
2. Shkresina e Shtatit Madhuer.
3. Komisioni i rregulloreve e i

Ndërrohet atasheu ushtarak i SHBA-së



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, priti në datë 14 janar 2014, në një takim të veçantë atasheun ushtarak të SHBA në vendin tonë, kapiten i rangut të dytë Glenn Brown me rastin e përfundimit të detyrës dhe atasheun e ri që merr detyrën, kapiten i rangut të dytë Ralph

Shield. Pasi u uroi mirëseardhjen, gjeneral Bazo, vlerësoi me nota maksimale bashkëpunimin e deritanishëm në fusha të shumta dhe të rëndësishme në fushën e mbrojtjes ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA, gjë që ka kontribuar në arritjen e standardeve të NATO nga Forcat e Armatosura shqiptare. Më tej, gjeneral Bazo shprehu gjithashtu vlerësime

për kontributin e kapiten i rangut të dytë Glenn Brown në forcimin e këtij bashkëpunimi, si dhe i uroi atasheut të ri ushtarak, kapiten i rangut të dytë Ralph Shield suksese në detyrën e rëndësishme. Kapiten i rangut të dytë Glenn Brown falënderoi gjeneral Bazon për mbështetjen e dhënë në kryerjen e detyrës së tij si atashe ushtarak në Shqipëri.

Puna në grup, disiplina dhe saktësia, sekretet e realizimeve

Batalioni i Transportit në Brigadën Logjistike kryen operacionet e para

Batalioni i Transportit në Brigadën Logjistike ka kryer operacionet e para të transportit të mjeteve dhe materialeve ushtarake dhe municioneve për vitin 2014. Në këto operacione janë realizuar mbi 20 mijë kilometra nga automjetet e tij për transport materiale ushtarake, municioneve nga grup depot në Uzinat Ushtarake. Operacioni më kryesor ka qenë transportimi i materialeve dhe tërë infrastrukturës teknike së gjashtë helikopterëve AB 206 nga Heliudromi i Farkës në Aerodromin Ushtarak të Kuçovës. Kapiten Egert Kuka, që drejton aktualisht Batalionin e Transportit është vënë në krye të këtij operacioni shumë kompleks dhe me përgjegjësi të madhe. Komandanti i kësaj Brigade gjeneralbrigade Syrja Gjoka konfirmon se janë marrë të gjitha masat si nga shtabi i Brigadës, por dhe nga tërë efektivi i Batalionit që të realizohet me shumë përgjegjshmëri, kompetencë dhe me saktësi operacioni i transportimit të helikopterëve AB 205, por dhe ai i municioneve nga grupdepot e në Uzinat Ushtarake, të cilat kanë filluar punë sipas planit kalendarik të vitit 2014. Kapiten Egert Kuka thotë se lëvizja e mjeteve u krye nën masa të repta sigurie, ku morën pjesë mjete të specializuara të shoqëruara me zjarrfikëse, një ambulancë dhe autokolona është shoqëruar nga policia ushtarake. I gjithë efektivi ishte shumë i ndërgjegjshëm për këtë përgjegjësi. Në fund të këtij operacioni u bë dhe analiza ku nga Komanda e Brigadës Logjistike u vlerësua përvoja dhe mbi të gjitha u vunë pikat mbi "i" për të gjitha problemet e konstatuara, të cilat nuk do të përsëriten në operacionet e tjera. Në këtë operacion të këtij fillim viti barrën kryesore e mbajti kapiten Klodian Liço shef i seksionit të operacioneve, i cili në bashkëpunim me kapiten Daniel Harka dhe toger Serafin Osmani mbajtën peshën kryesore të operacionit. Kapiten Romir Nuho, komandanti i Kompanisë Mbështetëse thotë se kjo detyrë u realizua falë përvojës dhe punës në grup. Tani ne kemi një numër të konsiderueshëm shoferësh, teknikësh dhe manovratorësh, të cilët i njohin rrugët e Shqipërisë me centimetra dhe janë të pagabueshëm dhe kur koha është e keqe dhe transporti bëhet në kushtet e errësirës. Në bisedë me shefin e personelit togere Elinora Metolli mëson se ngritja profesionale e tërë batalionit të transportit është e konsiderueshme dhe në përputhje me direktivat e shtabit epror. Të njëjtën gjë konfirmon dhe shefi i personelit të Brigadës Logjistike nënkolonel Fredi Mersini, i cili analizon

tërë punën karrierën dhe ngritjen profesionale të efektivit të Brigadës Logjistike. Ai veçon QAME e drejtuar nga kapiten Artan Azizi, i cili është një oficer dhe drejtues i përpiktë korrekt dhe shumë egzigjent me detyrën ashtu dhe shumë drejtues të rinj në shtabin e Brigadës, por dhe në reparte, të cilët janë në nivelet e kërkuara nga partnerët tanë të NATO s. Kapitenët Gerti Gjokmema dhe Hashim Kojku të Batalionit të Transportit i kanë kuptuar si duhet detyrat e vitit 2014 dhe direktivat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe në këtë operacion vërtetuan se dinë të drejtojnë. Kapiten Adriatik Breshani komandanti i kompanisë së tretë detyrën e transportit të municioneve nga grup depot drejt uzinave e quan si fillimin e një viti me shumë detyra të ngjeshura dhe të vështira. Një koncept të ri të punëve e ndesh gjatë gjithë kohës në Brigadën Logjistike. Duke filluar nga analiza ditore e punës e drejtuar nga gjeneralbrigade Syrja Gjoka apo drejtuesit e tjerë dhe duke përfunduar tek raportimi i zbatimit të detyrave. Në sekretarinë e Brigadës marrja dhe shpërndarja e tërë dokumenteve kryhet me përgjegjësi dhe majore Alba Tuci, shefe e sekretarisë e konsideron shumë të shenjtë sekretin ushtarak dhe procedurat e marrjes dhe ruajtjes së urdhrave dhe shkresave. Me përvojën e saj ajo ndjek çdo problem me shumë saktësi. Komandanti i Qendrës së Menaxhimit të Materialeve kolonel Lulëzin Xhafa që mban dhe barrën kryesore të menaxhimit të gjithë materialeve në ruajtje dhe në qarkullim konfirmon se detyrat e këtij viti janë shumë herë më të mëdha dhe më me shumë përgjegjësi. Specialistja e menaxhimit të materialeve tetare Marjana Kotarja thotë se detyra kërkon përkushtim dhe logjikë. Nëse ndjek ditën e shefit të ndërlidhjes nënkolonel Viktor Hysi dhe të radistes ushtares profesionale Anisa Elezi atëherë bindesh se kur punohet duhet të jesh korrekt, bashkëpunues dhe të respektosh punën, gradën dhe funksionin e çdo ushtaraku. Rregullat e hyrjes dhe daljes nga Brigada, por dhe tërë njësitë e Brigadës Logjistike janë forcuar dhe kryhen sipas rregullores pasi komandanti i kësaj Brigade disiplinën në punë e quan shumë primare. Ushtaret profesionale Antila Koka dhe Eva Xhepa që në hyrje të postbllokut kërkojnë korrektësi. Dinamika e punës ka filluar dhe gjatë ditës detyrat kryhen me përgjegjësi jo vetëm në Batalionin e Transportit, por dhe në QAME dhe në vetë shtabin e Brigadës. Garnizoni i Pezë Helmësit mban dhe barrën kryesore të detyrave.

Bashkim Male

Atashtetë ushtarakë të Republikës së Kinës, takim me komandantin e FT

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, priti në datën 10 janar 2014, në një takim të veçantë, me rastin e përfundimit të detyrës, atasheun ushtarak të Republikës Popullore të Kinës, kolonel i parë Fang Hua dhe kolonel i parë Luo Tiefeng i sapo akredituar. Gjeneral Dushku i njohu ushtarakët kinezë me aktivitetin që zhvillon Forca Tokësore, kontributet që ka dhënë dhe vazhdon të japë në shërbim të paqes e sigurisë. Gjatë takimit ai vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe kontributin e dhënë nga

atasheu ushtarak, kolonel i parë Fang Hua, gjatë periudhës së shërbimit në vendin tonë. Në mënyrë të veçantë, gjeneral Dushku u ndal vizitën e delegacionit të Policisë Ushtarake kineze në Forcë Tokësore. Gjatë takimit u diskutua me optimizëm për zgjerimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Kinës. Në përfundim të vizitës, kolonel i parë Fang Hua dhe kolonel i parë Luo Tiefeng falënderuan komandantin e Forcës Tokësore, gjeneral Dushkun për pritjen e ngrohtë dhe miqësore.



Atasheu i ri i Republikës së Kinës viziton Komandën e Forcës Detare

Paraditen e datës 10 janar, atasheu i ri i Republikës së Kinës, kolonel Luo Tiefeng, i shoqëruar nga kolonel Fang Hua, i cili e mbylli misionin në vendin tonë, zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare. Ushtarakët kinezë u pritën nga komandanti i Forcës Detare, gjeneralbrigade Qemal Shkurti dhe kuadro të tjerë të shtabit të FD. Fillimisht, gjeneral Shkurti i shprehu mirëseardhjen në komandën e FD atasheut të ri kinez dhe i uroi atij, punë të mbarë në vendin tonë. Ndërkohë kolonel Luo Tiefeng vlerësoi pritjen e rezervuar nga komandanti

i FD dhe shprehu kënaqësinë për vizitën në qytetin e bukur të Durrësit, miqësinë tradicionale midis popullit kinez dhe atij shqiptar dhe resurset turistike të vendit tonë. Në vijim Gjeneral Shkurti i njohu ushtarakët kinezë me misionin e FD, punën që po bëhet në kantierin e Pashalimanit për ndërtimin e anijeve të reja dhe procesin e reformimit të FD në të ardhmen për të arritur standardet e NATO. Gjatë takimit ushtarakët e dy vendeve theksuan zhvillimin e mëtejshëm të traditës e marrëdhënieve miqësore midis dy popujve tanë.

Aktivitetet kryesore të vitit 2013

Prioriteti më i lartë për Aleancën gjatë vitit 2013 ka qenë ndërtimi i kapaciteteve për forcat e sigurisë afgane në mënyrë që ato të marrin rolin udhëheqës për sigurinë në të gjithë vendin e tyre përpara tërheqjes së forcave të NATO-s në Afganistan në fund të vitit 2014. Gjithashtu, u zhvilluan përgatitje të hollësishme për misionin e ri të udhëhequr nga NATO pas vitit 2014, të cilat do të trajnojnë, këshillojnë e ndihmojnë forcat afgane.

Raketat Patriot në Turqi - 26 janar 2013

E para nga gjashtë bateritë e raketave Patriot, të cilat u vendosën në Turqi për mbrojtjen kundër sulmeve të mundshme raketore nga ana e Sirisë, u bënë operacionale dhe u vendosën nën komandën e NATO-s.

Vizita historike në Irlandë - 12-13 shkurt 2013

Në vizitën e parë në Irlandë të një Sekretari të Përgjithshëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen u takua me udhëheqësit irlandezë dhe ministrat e Mbrojtjes së Bashkimit European në Dublin.

Bashkëpunim më i thellë me Australinë - 21 shkurt 2013

NATO dhe Australia përcaktuan prioritetet për një program bilateral bashkëpunimi si dhe forcimin e mëtejshëm të partneritetit të NATO-s me vendet e Azi-Paqësorit.

Afganët zhvillojnë sulmin e parë ajror - 11 mars 2013

Duke demonstruar aftësitë e tyre rritëse, Forca Ajrore Afgane, e cila këshillohet nga Komanda Trajnuese Ajrore e NATO-s, Afganistan, koordinoi sulmin e saj të parë ajror me Forcat Speciale të Ushtrisë Afgane.

Vizita e parë në Republikën e Koresë - 12 prill 2013

Anders Fogh Rasmussen synoi rritjen e bashkëpunimit gjatë bisedimeve me presidentin Park Guen-hye dhe zyrtarë të lartë qeveritarë, gjatë vizitës së parë të një Sekretari të Përgjithshëm të NATO-s në Republikën e Koresë. Ai e përfundoi udhëtimin e tij me një vizitë të shkurtër në Zonën e Demilitarizuar.

NATO dhe Kina kundër piraterisë - 14 prill 2013

Në frymën e bashkëpunimit, forcat e NATO-s kryen një stërvitje të përbashkët me një anije detare kineze gjatë operacioneve kundër piraterisë në Gjirin e Adenit. Një ekip marinsësh italianë, të dislokuar si pjesë e operacionit të NATO-s, Ocean Shield (Mbujoja Oqeanike), demonstruan një përfshirje të shpejtë në kuvertën e CNS Harbin, anije kineze e Task Group.

Partneritet më i fortë me Japoninë - 15 prill 2013

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen dhe kryeministri japonez Shinzo Abe nënshkruan një Deklaratë të Përbashkët Politike, duke garantuar një tablo për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit.



Ruajtja e traditës mbretërore - 30 prill 2013

Avionët mbikëqyrës të NATO-s, të njohur si AWACS, patrulluan qiejt mbi kryeqytetin holandez, Amsterdam, në bashkëpunim me Forcat Ajrore Mbretërore të Holandës për të mbrojtur hapësirën ajrore holandeze gjatë ceremonive dhe festimeve të emërimeve mbretërore.

Misioni post 2014 në Afganistan - 5 qershor 2013

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s mbështetën konceptin për misionin e ri të udhëhequr nga NATO, i cili do të trajtojë, këshillojë dhe ndihmojë forcat e sigurisë afgane pas vitit 2014 kur të përfundojë misionin i Forcave të Sigurisë Ndërkombëtare të udhëhequr nga NATO.

Logjisticienët në "Botën e Magjishme" - 8-26 qershor 2013

Forcat e NATO-s u dislokuan në vendin fiktiv të "Botës së Magjishme" për të vendosur sisteme logjistike, pajisje dhe procedura për të vënë në provë atë që është stërvitja më e madhe logjistike e Aleancës. E zhvilluar në Sllovaki, Logjistika e Aftë 2013, përfshiu vendet anëtare dhe partnere të NATO-s në një krizë të simuluar, e cila përfshinte konfliktet ndëretnike dhe vërshimin e refugjatëve.

Zbulimi i bombave vetëvrasëse - 11 qershor 2013

Teknologjia për zbulimin e largët dhe në kohë reale e lëndëve plasëse u testua drejtpërdrejt në një stacion nëntokësor në një kryeqytet të madh europian. Teknologjia në terren ishte rezultati i një pune të përbashkët katër-vjeçarë ndërmjet ekspertëve të NATO-s dhe atyre rusë.

Afganistani në udhëheqje të sigurisë - 18 qershor 2013

Presidenti Hamid Karzai shpalli grupin e pestë dhe të fundit të provincave, qyteteve dhe rretheve që ju nënshtruan tranzicionit të udhëheqjes afgane të sigurisë gjatë muajve në vijim. Ndërkohë që kjo fazë e fundit tranzicioni kompletohej, roli i forcave të udhëhequra nga NATO u zhvendos nga luftues në mbështetës.

Vizita e një niveli të lartë në Gjeorgji - 26-27 qershor 2013

Gjatë vizitës dy-ditore të Këshillit të Atlantikut të Veriut në Gjeorgji për të vlerësuar përparimin që kishte bërë vendi në drejtim të integritimit euroatlantik, aleatët lavdëruan progresin dhe inkurajuan reformat e mëtejshme. Gjithashtu, ata falënderuan Gjeorgjinë për kontributin e saj në Afganistan, e cila aktualisht është vendi jo-anëtar më i madh kontribuues me trupa të NATO-s.

FSK: Kapacitet i plotë operacional - 9 korrik 2013

Këshilli i Atlantikut të Veriut deklaroi se Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur kapacitetin e plotë operacional. Kjo forcë e armatosur lehtë është përgjegjëse për operacionet e mbrojtjes së civilëve dhe ndihmën e autoriteteve civile në përgjigje të katastrofave natyrore dhe emergjencave të tjera.

Shoqërimi i anijes më të madhe në botë - 8 gusht 2013

Fregata holandeze HNLMS Van Speijk, pjesë e operacionit të NATO-s, Ocean Shield, kundër piraterisë, siguroi kalimin e sigurt të anijes së mallrave Maersk McKinney Moller, aktualisht anija më e madhe në botë, ndërkohë që ajo tranzitonte në Gjirin e Adenit.

Stërvitje të drejtpërdrejta në qiejt e Norvegjisë - 26 gusht-5 shtator 2013

Avionë dhe helikopterë luftarakë nga 9 vende të NATO-s morën pjesë në stërvitjen e drejtpërdrejtë "Brilliant Arrow", në Bazën Ajrore Oerland në Norvegjinë Perëndimore. Ajo ishte e para nga një sërë stërvitjesh që testuan aftësitë dhe ndërveprimin e Forcës Reaguese të NATO-s, e cila arriti kulmin në stërvitjen "Steadfast Jazz", në muajin nëntor. Atje morën pjesë 50 avionë ushtarakë dhe një staf prej 800 vetash nga Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Portugalia, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Qendra e re e Ekselencës së Sigurisë së Energjisë - 6 shtator 2013

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen dhe presi-

denti i Lituaniës, Dalia Grybauskaitė, inauguruan Qendrën e Ekselencës të Sigurisë së Energjisë të NATO-s në Vilnius. Qendra siguron analiza mbi zhvillimet e energjisë, siguron trajnim dhe edukim si dhe ndihmon në përmirësimin e efikasitetit të energjisë së Forcave të Armatosura. Kjo është e fundit nga një numër Qendrash Ekselence të NATO-s, e cila u ngrit për të trajtuar një gamë sfidash energjie që shfaqen.

NATO-OKB: Momenti historik 5-vjeçar - 23 shtator 2013

Ndërkohë që udhëheqësit e botës u mbledhën në Nju Jork për sessionin vjetor plenar të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, NATO shënoi përvjetorin e pestë të nënshkrimit të Deklaratës të Përbashkët për Bashkëpunimin e Sekretariatit OKB-NATO, i cili e ka çuar bashkëpunimin e stafit midis dy organizatave në një nivel më të lartë.

Stërvitja në qiejt NATO-Rusi - 27 shtator 2013

Avionë luftarakë të Forcave Ajrore nga Polonia, Turqia dhe Rusia, së bashku me kontrollorët e trafikut ajror, kryen me sukses stërvitjen e drejtpërdrejtë të përbashkët NATO-Rusi, "Vigilant Skies 2013" (Qiejt Vigjilentë 2013), kundër terrorizmit.

"Brilliant Mariner" (Marinari Brillant) - 30 shtator 2013

Një flotë e madhe luftanijesh kreu manovra në brigjet italiane si pjesë e stërvitjes "Brilliant Mariner", për të testuar dhe provuar aftësinë e njësive nga vende të ndryshme të NATO-s për të punuar së bashku si pjesë e Forcës së Reagimit të NATO-s.

Ukraina i bashkohet operacionit "Ocean Shield" - 10 tetor 2013

Një fregatë detare ukrainase iu bashkua operacionit të NATO-s "Ocean Shield", duke shënuar herën e parë që një komb partner kontribuon në përpjekjet e NATO-s kundër piraterisë, e cila ka vepruar në Bririn e Afrikës që nga viti 2009.

Ekipi këshillues i NATO-s për Libinë - 21 tetor 2013

Në përgjigje të një kërkesë nga ana e qeverisë libiane, aleatët e NATO-s ranë dakord të krijonin një ekip të vogël këshillues për t'ju ofruar këshilla autoriteteve libiane mbi ndërtimin e institucioneve të mbrojtjes, si pjesë e përpjekjeve të përgjithshme të komunitetit ndërkombëtar.

Gratë, paqja dhe siguria - 23 tetor 2013

Një shqyrtim i pavarur konstatoi se NATO dhe partnerët e saj operacionale kanë bërë progres të rëndësishëm në përpjekjet për të zhvilluar një perspektivë gjinore në operacionet e drejtuara nga NATO në Afganistan dhe Kosovë, por ky konstatim thotë gjithashtu se "ka vend për përmirësim".

Zhvillohet stërvitja "Steadfast Jazz" - 2 nëntor 2013

Stërvitja më e madhe e Aleancës që nga viti 2006, "Steadfast Jazz", nisi në shtetet Baltike, Poloni dhe në të gjithë bazat e NATO-s në Europë. Stërvitja një-javore përfshiu rreth 6.000 trupa, duke përfshirë ajrin, tokën, detin si dhe komponentë të forcave speciale. Një nga qëllimet e saj ishte testimi i stafit të shtabeve ushtarake që do të drejtojnë Forcën e Reagimit të NATO-s në vitin 2014.

Ndihma ndaj Irakut për ndalimin e IED - 18-22 nëntor 2013

Si pjesë e përpjekjeve të NATO-s për të ndihmuar përmirësimin e aftësive së personelit të Irakut dhe për të trajtuar kërcënimin e pajisjeve plasëse të improvizuara (IED), u mbajt në Sllovaki një kurs i parë trajnimit në Qendrën e Ekselencës për Shkatërrimin e Lëndëve Plasëse, me mbështetjen e Programit Shkencor të NATO-s për Paqen.

Stërvitja vjetore mbi mbrojtjen kibernetike - 26 nëntor 2013

NATO zhvilloi një stërvitje tre-ditore të mbrojtjes kibernetike, "Koalicioni Kibernetik 2013", për të testuar aftësinë e Aleancës në lidhje me mbrojtjen e rrjetit të saj nga sulmet kibernetike. Me më shumë se 30 kombe të përfshirë, kjo ishte stërvitja më e madhe e këtij lloji.

Rruga drejt samitit të vitit 2014 - 3-4 dhjetor 2013

Prioritetet për samitin e ardhshëm të NATO-s që do të mbahet në muajin shtator të vitit 2014, ishin në krye të rendit të ditës në takimin dy-ditor të ministrave të Jashtëm të NATO-s në Bruksel. Ata ranë dakord se temat kryesore do të jenë: Investimi në aftësitë e duhura dhe në partneritetet e forta për të mbetur të fuqishëm dhe të gatshëm për t'ju përgjigjur sfidave të ardhshme të sigurisë; përforcimi i lidhjeve transatlantike si dhe përgatitja për të hapur një kapitull të ri në angazhimin e NATO-s në Afganistan. Samiti do të pritet nga Mbretëria e Bashkuar në Nju Port, Uells Jugor.

Transformimi - ambicie dhe sfidë e Forcave të Armatosura për 2014

NGA: Nënkolonel (r) Kanan HIMAJ
Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Transformimi ushtarak përfaqëson një instrument efektiv të veçantë në konsolidimin e rolit të mbrojtjes në kuadrin e politikave të sigurisë. Forcat tona të Armatosura kanë kaluar një proces të gjerë të reformave dhe modernizimit, e cila ka bërë të mundur krijimin e një ushtrie të re, më të vogël në kushtet e sistemit të ri demokratik, me kapacitete të besueshme dhe efektive për mbrojtjen, të përshtatura me mjedisin e ri të sigurisë në rajon dhe në mjedisin e sigurisë globale. Procesi i reformimit të Forcave të Armatosura ka qenë dhe është i lidhur në mënyrë të natyrshme me kërkesat e sistemit planifikimin e mbrojtjes së Aleancës Euro-Atlantike, e cila ka dhënë frytet e veta në aspektet e sigurisë së vendit. Në përkufizimin për transformimin pranohet se, ai përfshin ndryshime në nivelin e doktrinat forcave, organizimin dhe strukturat, aftësitë, aktiviteti dhe informacioni, trajnimi, edukimi, personelit, menaxhimi i programimit buxhetor dhe fushat kryesore të zbatimit të transformimit. Direktiva e ministres së Mbrojtjes për vitin 2014 përbën boshtin e punës për realizimin e angazhimeve tona ndaj Aleancës, BE dhe OKB, e cila është një ndërmarrje e rëndësishme për të ofruar kapacitete në dispozicion të tyre. Kjo përfshin gjithë hapësirën e detyrave të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive, me theksin e konceptit ri të sigurisë dhe pjesëmarrja aktive në procesin e zhvillimit të aftësive të reja. Pra, kjo çështje do të tregojë nivelin e transformimit të mbrojtjes tonë në thelb, drejt një perspektive moderne dhe e përshtatur shpejt me ushtritë e tjera aleate, me besueshmërinë e lartë ndaj tyre.

Sfidat për zhvillimin e Forcave të Armatosura

Procesi i transformimit të mbrojtjes do të kalojë në një rrugë të gjatë me sfidat e mëdha në sistemin e mbrojtjes për: cilësinë e strukturës së re, madhësia e personelit, burimet e kufizuara të mbrojtjes dhe përdorimi i tyre; realizimit të aftësive luftarake të ndërveprueshme me aleatët (objektivat e forcës); mbajtja e nivelit të gatishmërisë së planifikuar të njësive, teknikës, pajisjeve etj, për operacione; kërkesat në rritje të bashkëpunimit për misione dhe operacionet ndërkombëtare; promovimi i një konsensusi të gjerë politik në vend për reformat e mbrojtjes dhe mbështetjen e transformimit etj. Niveli i ambicies për mbrojtjen e



vendit në bashkëpunim me forcat aleate, sipas Nenit 5, është deri në një Brigadë të Përforuar (Brigadë Task Forcë) ose deri tre Grup Batalione të Përforuar. Ndërsa, kontributi i RSH për mbrojtjen kolektive të territoreve të Aleancës sipas Procesit të NDPP9 është 1 grupim taktik "grup-batalion i këmbësorisë së lehtë të motorizuar" me angazhim 6 muaj deri në një vit, pa rotacion të mëtejshëm, të konfiguruar sipas misionit konkret. Niveli i ambicies për pjesëmarrje në operacione NA5CRO11, jashtë Nenit 5, kryhet mbi bazën e konceptit të "një grupimi të vetëm forcash" për NATO/BE/OKB/ apo Koalicione të mundshme, përtej kufijve kombëtare dhe aleate. Ky NiA është jo më shumë se tre kompani njëherësh në operacion, me rotacion disa herë. Pjesëmarrja mund të bëhet edhe me kapacitete të specializuara 'Niche', grupe të forcave speciale/komando, si dhe ekspertë

(civil dhe ushtarakë) trajnues, këshillues, koordinatorë, vëzhgues etj, sipas Sistemit të Ponderimit të Forcës, të pranuar nga Aleanca. Niveli i ambicies për përballimin e Emergjencave Civile në mbështetje të autoriteteve në emergjencat civile brenda vendit është mbështetja e një emergjence në nivel Batalioni të Përforuar (Batalion Task Force), ose e dy emergjencave të njëkohshme në nivel Kompanie të Përforuar (Kompani Task Force). Kjo mbështetje për autoritetet civile qendrore dhe lokale kryhet kur kapacitetet e tyre janë

të pamjaftueshme, apo kur FASH sjellin një ekspertizë të veçantë që nuk disponohet nga institucionet e tjera. Niveli i ambicies bazohet në përcaktimin e angazhimeve konkrete për mbrojtjen kombëtare dhe ato për aleatët. Balancimi i ambicies politike me burimet e mbrojtjes do të jetë në vëmendjen e të gjithë piramidës së drejtimit, duke synuar që rritja e përqindjes të vijë nga 1.3% në vitin 2013 në 1.5% deri 2% në vitin 2020. Duke u nisur sa më lart, mungesat në planifikimin e pabazuar në burimet e mbrojtjes sjell mos realizimin e nivelit të ambicies të miratuar, dhe rrjedhimisht do të rezultojë në

potencialin e tyre për përmbushjen e detyrave brenda vendit, por edhe në interes të mbrojtjes dhe sigurisë kolektive. Mos shfrytëzimi racional i mbështetjes me burime njerëzore dhe financiare të kufizuara ngadalëson zhvillimin e aftësive, ose ndryshon afatin kohor të fazave të zhvillimit, e për rrjedhojë dëmton kredibilitetin tonë në mjedisin ndërkombëtar. Mungesat në zbatimin e detyrave sipas fazave të planit, për shkak të madhësisë të paekuilibruar të strukturave, niveli i pamjaftueshëm i gatishmërisë operacionale, sidomos i njësive dhe reparteve prioritare ka efekt negativ në tërësinë e plotësimit të kërkesave dhe objektivave të politikës së mbrojtjes.

Analiza me bazë konkrete të problematikës në çështjet e mbrojtjes dhe vonesat subjektive në procesin e integritetit të plotë në strukturën e NATO zvogëlojnë potencialin operacionel dhe aftësitë për bashkëpunim me aleatët, rrjedhimisht do të ulen

kredibiliteti i vendit.

Realizimi i objektivave tregon nivelin e transformimit të forcës

Në kohën e tashme, mjedisi i sigurisë është formësuar nga kërkesat me karakter të thellë transformues për potencialin ushtarak, si ulja e ndjeshme e numrit të limiteve të personelit, marrja në konsideratë dhe përlllogaritjet ekonomike, zbatimi në praktik i konceptit "smart defence", ndërveprimet me vendet e tjera për zgjidhjen e problematikës dhe marrjen e përvojës si një ushtri e një

sistemi demokratik, rritja e fushës së veprimit diplomatik dhe vendosja në agjendë të projekteve, progresi teknologjik, revolucionarizimi në çështjet ushtarake dhe globalizimi etj. Në ditët e sotme, politika e mbrojtjes dhe sigurisë përfshin detyra të reja për Forcat tona të Armatosura.

Përfshirja e Forcave të Armatosura në veprimet me karakter jo-ushtarak, i përgjigjet kërkesave për të siguruar efikasitetin e veprimit dhe kapacitetin e reagimit ndaj çështjeve të interesave kombëtare. Në këtë drejtim, ato kanë rritur ndjeshmërinë dhe kapacitetet e angazhimit në misionet e stabilizimit dhe rindërtimit, në operacionet me dimension më të theksuara civile, në operacionet e ndërhyrjes ndaj fatkeqësive të ndryshme. Kështu, edhe në perspektivë ushtria do të synojë të nxjerrë në pah koordinim mes institucioneve qendrore dhe lokale.

Procesi i transformimit ushtarak është në linjë me transformimin në nivel të Aleancës dhe komponentin e mbrojtjes të BE-së për zhvillimet e ardhshme në sigurinë evropiane. Politika e mbrojtjes vazhdon të mbështesë procesin e gjerë të transformimit për të siguruar më shumë përgjigje efektive ndaj kërcënimeve të reja dhe të krijojnë kapacitete për veprimtari globale dhe për një reagim të shpejtë për të gjithë diapazonin e misioneve të supozuara.

Transformimi ofron mundësinë e rishikimit të shpeshtë të strukturës, pajisjen dhe trajnimin e forcave ushtarake për të përmbushur më vete dhe në koalicione detyrat tona të mbrojtjes dhe ato ndërkombëtare në kuadrin shumëkombësh duke u nisur nga misionet e reja në kuadrin e sigurisë. Në angazhimet ndërkombëtare, reforma e Forcave të Arma-

Në përkufizimin për transformimin pranohet se, ai përfshin ndryshime në nivelin e doktrinatve të forcave, organizimin dhe strukturat, aftësitë, aktiviteti dhe informacioni, trajnimi, edukimi, personelit, menaxhimi i programimit buxhetor dhe fushat kryesore të zbatimit të transformimit

paaftësinë për të përmbushur të gjitha misionet dhe detyrat brenda dhe jashtë vendit. Pra, niveli i ambicies do të jetë vijimi i plotësimit të programeve të mbrojtjes si: pajisjet për Grup Batalionin, pajisjet e kërkimshpëtimit; armatimin individual, modernizimin e mjeteve të transportit, pajisjet luftarake individuale, pajisjet SNI, vijimi i procedurave për blerjen e helikopterëve, ndërtimin e anijeve patrulluese, etj. Menaxhimi jo i mirë i këtyre sfidave mund të dështojë arritjen e qëllimeve afatgjata, pasi zvogëlon

tosura dhe modernizimi zhvillohet në krijimin e forcave me aftësi të dislokueshme, me kapacitet për të vetë-mbështetur në fushat e operacioneve dhe kapacitete të mira për të reaguar në një kohë të shkurtër. Sot vijon puna për përmirësimin e krijimit të kapaciteteve për operacione të përbashkëta, për gjenerimin e aftësive dhe efikasitetin e përdorimit të burimeve të mbrojtjes etj, të cilat janë gjithëpërfshirëse në fushën e veprimtimit të përbashkët me NATO-n. Procesi i transformimit të FA lidhet edhe me rishikimin e rolit, misioneve dhe detyrave të FA, pasi ai përbën boshtin e zhvillimit të planifikimit afatgjatë. Kërkesa është për krijimin e një force të vogël profesioniste, të motivuar, të mirë-trajnuar, të pajisur, të ndërveprueshme dhe të aftë për të përmbushur me profesionalizëm detyrat e misionit kushtetues, sipas setit të skenarëve të parashikuar brenda dhe jashtë vendit. Koncepti i rishikimit të rolit do të jetë sipas sasisë, cilësisë së kapaciteteve dhe aftësive për kryerjen e misionit, me cilësinë e një ushtrie moderne, si një forcë me kapacitete modeste dhe të vogla, e aftë për të vepruar në mjedisin e ardhshëm të sigurisë. Rishikimi i planit të evidentojë tepricat dhe mangësitë e kapaciteteve të FA të RSH, strukturat paralele dhe dublikimet e kapaciteteve midis shërbimeve të FA. Rishikimi i rolit dhe misionit të FA të orientojë Listën e Detyrave Themelore të Misionit për nivelin e detyrave strategjike, operative dhe taktike të njësive (ST,OT,TT), bazuar në eksperiencën e Listës së Detyrave të NATO (NTL).

Gjithashtu, rishikimi dhe planifikimi i perspektivës përfshin hapësirën e zbatimit të misionit kushtetues të Forcave tona të Armatosura për mision për mbrojtje, misione mbështetëse të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe kontribute në kohë paqe. Për sa më lart rol të rëndësishëm në transformimin e FA ka Administrata e Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcat e Armatosura (SHPFA), të cilët drejtojnë tërë procesin e reformave për krijimin e strukturës të mbrojtjes. Transformimi i strukturës kërkon që madhësia dhe struktura, personeli, komanda dhe kontrolli, logjistika, inteligjenca, komunikimi dhe sistemi i informacionit, edukimi dhe trajnimi etj, të zhvillohen në përshtatje me realizimin e qëllimeve, zhvillimin e aftësive dhe sidomos për realizimin e objektivave të forcës (OF).

Rritja e shpejtësisë në operacione ka nevojë për rritjen dhe përshtatjen institucionale të kapaciteteve të nevojshme në korrelacion me përmirësimin e bashkëpunimit ndër-agjenci, bashkëpunim dhe përsosje në mekanizmin e kontrollit civil dhe demokratik mbi Forcat e Armatosura. Gjithashtu, do të jetë në vëmendje të veçantë për forcat ushtarake krijimi i kapaciteteve për të vepruar me organizatat joqeveritare, të cilat luajnë rol në rritje e operacionalitetit aktual dhe në mënyrë efikase të ndërveprojnë me popullatën civile në fushat e operacioneve.

Në fushën konceptuale, procesi i transformimit ushtarak i përket rishikimit të doktrinaeve të sistemit, trajnimi i forcave dhe udhëheqja e operacioneve si defekte esenciale në ditët e sotme. Ajo që duhet theksuar është futja graduale, përlllogaritja reale e efektit të operacioneve, qasja e tyre bazuar në kapacitetet e nevojshme, duke vënë theksin në modelin e bazuar në konsumin e forcave dhe burimeve për rritjen e kapacitetit dhe saktësinë, duke përdorur teknologjinë e informacionit, decentralizimi i nivelit taktik dhe operativ në kohë reale të përdorimit të informacionit.

Në fushën e planifikimit ushtarak, misionet e reja të Forcave të Armatosura kanë nevojë për përsosje të sistemit dhe për ri-përcaktimin e koncepteve të planifikimit të strategjisë dhe mbrojtjes në mënyrë që të rrisë kapacitetin për t'u përshtatur sfidave dinamike bashkëkohore dhe perspektiva e përdorimit më efikas të burimeve për mbrojtjen dhe fusha të tjera të sigurisë.



Transformimi ushtarak është i vazhdueshëm, proces jashtëzakonisht kompleks. Profesionalizmi është kryefjala e reformave për konsolidimin e forcës profesioniste dhe strukturës së saj. Reformat i shërbejnë përshtatjes së funksioneve me personelin e aftë për detyrat. Në vazhdim të saj, transformimi duhet të përfshijë dy komponentë vitale: inovacioni dhe modernizimi për të ruajtur kulturën e ndryshimit, për të siguruar avantazhe në konkurrencë të veçanta për epokën informative, për riorganizimin e liderit dhe edukimin e procesin organizativ. Për këtë aspekt, kërkesë themelore e transformimit është vazhdimësia e pohuar në krijimin dhe parashikimin e të ardhmes që lidhet me konceptet, proceset, organizatat / strukturat dhe teknologjitë moderne. Prandaj, transformimi ushtarak duhet të konsiderohet si një proces themelor një rëndësie që lidhet intensitetin kombëtar.

Transformimi kuptohet si mjet për të përshtatur Forcave e Armatosura me karakteristikat e reja të mjedisit të sigurisë. Transformimi perceptohet

si fushë e reformës së mbrojtjes që përfshin sistemin e arsimimit dhe stërvitjes, modernizimin e armatimit, teknikës dhe infrastrukturës ushtarake, përmirësimi i metodave të burimeve njerëzore dhe praktikave të burimeve njerëzore dhe praktikave të personelit), rivlerësimin e Sistemit të Programimit, Planifikimi dhe Buxhetimi (PPBS), në kontekstin e kërkesave të reja nga faza në fazë sipas vizionit të politikës së mbrojtjes, idesë së liderit për madhësinë e forcave, duke kaluar nga planifikimi i bazuar në kërcënime në planifikimin e aftësive bazë.

Transformimi kuptohet si efekt në Forcat e Armatosura, ai presupozon zbatimin e doktrinaeve të reja të forcave sipas parimeve të përdorimit të tyre në kushtet e pajisjeve të reja dhe të njësuara me aleatët, përshtatja e pajisjeve me zhvillimin teknologjik, me kërkesat e epokës informative dhe bashkëveprimin e forcave në sistemin e drejtim komandimit të gjitha niveleve.

Veprimtaria e Forcave të Armatosura kërkon ritme dhe ndryshime për procesin e trajnimit bazë, të doktrinaeve moderne për një gamë të gjerë të orientuar në qëllimet e misioneve klasike dhe jo konvencionale, që korrespondon me mjete të reja të liderit të luftës. Tani është koha të zhvillojë kapacitetet adekuate për ndërhyrje humanitare dhe stabilizimi për të mbështetur autoritetet publike në situata të emergjencave civile, të krijuara nga faktorët gjeofizikë natyrorë, meteorologjike - klimatike apo të tjera, si dhe në misionet e sigurisë publike në përputhje me dispozitat kushtetuese, të ligjeve të vendit dhe detyrimet e marra përsipër në organizatat e sigurisë ku merr pjesë. Një vëmendje e veçantë është për transformimet në fushën e planifikimit të mbrojtjes dhe për këtë arsye do të finalizohet procesi i procedurave kombëtare të planifikimit me procedurat standarde që funksionojnë në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Transformimi i mbrojtjes nuk është

Ajo duhet të jetë për të shmangur paralelizma dhe përdorimin efikas të burimeve, përkatësisht një qasje të bashkërenduar dhe koordinuar i projekteve kombëtare dhe multilaterale. Në mënyrë që të promovojë identitetin rajonal, Shqipëria do të mbështesë një strategji komunikimi e fokusuar në nivelin e integritit euro-atlantik.

Sistemi i mbrojtjes së vendit përfshin tërësinë e mjaft elementëve, të cilët kërkojnë reformë rrënjësore, si një vend i vogël, por me një potencial modest dhe të sigurt. Kjo kërkon konsensus dhe një klimë pozitive të plotë të ambientit politik në vend. Kërkesa është që ndryshimet strukturore të bëhen të mbështetura në ligj, praktika rrjedhëse drejtuese dhe kontrolluese ku të dallojnë: (kontrolli, inspektimet dhe kontrolli i brendshëm), mbështetja (inteligjencës, sigurisë, komunikimit dhe informacioni, pajisjet, menaxhimin të infrastrukturës, financave, kontabiliteti i personelit, standardizimi dhe kodifikimi, çështjet e përgjithshme dhe funksionet e tjera mbështetëse).

Transformimi i çështjeve ushtarake në nivelin strategjik, operacional dhe taktik kërkojnë rishikimin e plotë të metodës së drejtimit funksional. Ajo të sjellë parandalimin e punës paralele të funksioneve në zinxhirin e komandimit nga piramida në bazë. Procesi i transformimit dhe zbatimi i programeve të mbrojtjes do të kalojë në një rrugë të gjatë dhe ka disa momente kryesore, të cilat janë sfida për FA si: cilësia dhe madhësia e duhur e personelit, burimet e kufizuara të mbrojtjes dhe përdorimi i tyre; realizimi i aftësive luftarake të ndërveprueshme me aleatët (objektivat e forcës); ristrukturimi organizativ brenda mundësive me një madhësi racionale të personelit; mbajtja e nivelit të gatishmërisë së planifikuar të njësive, teknikës, pajisjeve etj, për operacione; kërkesat në rritje të bashkëpunimit për misionet dhe operacionet ndërkombëtare; promovimi i një konsensusi të gjerë politik në vend për reformat e mbrojtjes dhe mbështetjen e transformimit.

Përfundim

Nisur sa më lart transformimi të konceptohet dhe të vepohet si një proces i gjerë, i sistemuar dhe i detajuar me plane dhe programe të cilat mbështeten në burimet e mbrojtjes.

Përvoja e fituar në vite dhe baza që kemi krijuar të shërbejë për të hedhur hapa më të sigurt në rrugën e modernizimit të forcës, përshtatjen e elementeve të sistemit mbrojtjes me aleatët, duke shmangur formalizmin dhe synimi të jetë që ajo të krijojë kapacitete për vete dhe aleatët. Kjo të jetë një ndër masat e matjes të peshës dhe përgjegjësisë së punës në zinxhirin e drejtimit dhe komandimit në FA. Ndërtimi i forcës të jetë sipas misionit, detyrave, për të ruajtur ekuilibrin, nivelin e gatishmërisë operative, sidomos i njësive dhe reparteve prioritare, të cilat janë promotori i realizimit të kërkesave dhe objektivave të politikës së mbrojtjes dhe në mënyrë të drejtë të rriten aftësitë e bashkëpunimit me aleatët.

Rishikimi i sistemit të mbrojtjes konsiderohet si një proces strategjik, si pjesë në procesin transformues të komponentëve të mbrojtjes. Në këto rrethana, qëllimi konsiston në sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për të promovuar dhe mbrojtur interesat kombëtare ndaj kërcënimeve të tanishme dhe të ardhshme. Realizimi i qëllimit pohon krijimin dhe aftësinë e fituar, fleksibilitet për projektet dhe më tej, mbështetja e fushave të operacioneve për të vepruar sipas misionit në: konfliktet me intensitet të ulët; operacionet për reagim ndaj krizave; veprimet në emergjencat civile dhe ndihmës humanitare; sipas nenit V dhe jo-V të Traktatit të Uashingtonit.

Është momenti të theksojmë se transformimi i FA ka përfshirë disa aspekte që kanë qëllim të sjellin ndryshime në konceptet doktrinaeve, organizative dhe strukturore, nevojë për të përshtatur konceptimin e operacioneve brenda dhe jashtë vendit, aftësitë e udhëheqjes për rreziqet dhe kërcënimet e reja, përshtatja e strukturës së forcave me teknologjitë e reja etj.

një qëllim në vetvete, por është përgjigja adekuate për evoluimin e mjedisit të sigurisë dhe për angazhimet e marra në planin ndërkombëtar. Ai bëhet në përshtatje me ambientin e sigurisë, gjendjen reale të zhvillimit dhe mundësitë e mbështetjes për perspektivën e FA. Gjithashtu, do të jetë në përshtatje me kërkesat e politikës së mbrojtjes dhe të sistemit të mbrojtjes, administrimi më i mirë dhe një mjedis mbështetës i gjerë i shoqërisë. Pritjet dhe kërkesat e shoqërisë në drejtim të FA i referohen veçanërisht transparencës, profesionalizmit, racionalitetit, realizimit efikas të misioneve dhe detyrave të tyre.

Prioritare është zhvillimi i programeve për të rritur kapacitetet kombëtare dhe rajonale për monitorimin, ndërhyrja e shpejtë për të parandaluar dhe luftuar rreziqet. Gjithashtu, kjo do të kërkojë përmirësimin e kornizës legjislativë për të rritur besimin në nivelin rajonal. Përqasje koherente nënkupton ekzistencën e nivelit kombëtar ndër-agjencive dhe promovimin e identitetit rajonal (të aleatëve dhe partnerëve).

Komandanti i Forcës Tokësore priti atashetë e Mbrojtjes së SHBA-së

Me datë 15 janar 2014, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, priti në një takim të veçantë atashetë e Mbrojtjes të SHBA në vendin tonë, Kapitenin e Rangut të Dytë Glenn Brown me rastin e përfundimit të detyrës dhe atashen e ri që merr detyrën, kapitenin e Rangut të Dytë Ralph Shield. Gjeneralmajor Dushku, pasi ju uroi mirëseardhjen vlerësoi kontributin e Zyrës së Atasheut të Mbrojtjes dhe të SHBA, në forcimin e marrëdhënieve midis FA Amerikane dhe Forcave Tokësore, e shprehur kjo nëpërmjet realizimit të një sërë projektesh bashkëpunimi, që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe modernizimin e FA, edukimin stërvitjen dhe trajnimin e personelit të FT-së, përfshi dhe gjuhën angleze. Ai falënderoi, kapitenin e rangut të dytë Brown për bashkëpunimin gjatë kryerjes së detyrës si atashë i Mbrojtjes i SHBA në Shqipëri dhe njëkohësisht i uroi sukses në karrierën e tij ushtarake. Atasheu ushtarak i SHBA në vendin tonë, kapitenin e rangut të dytë Glenn Brown shprehu falënderime për



komandantin e FT-së, gjeneral Dushku, për mbështetjen e dhënë në kryerjen e detyrës së tij si atashë i Mbrojtjes në Shqipëri dhe vlerësoi arritjet e deritanishme në Forcat Tokësore. Më pas, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Dushku, i uroi kapitenit të rangut të dytë Ralph Shield, suksese në detyrën si atashë i Mbrojtjes dhe e garantoi për një bashkëpunim të suksesshëm edhe në të ardhmen.

"Workshop", për problematikën e stërvitjes

Ditën e mërkurë, date 15 janar 2014 në ambientet e Forcave Tokësore, nën drejtimin e Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes në FT u zhvillua "Workshop", mbi problematikën e stërvitjes. Në këtë aktivitet merrnin pjesë shefat e seksioneve të operacioneve dhe stërvitjes në reparte dhe specialistët e stërvitjes, komandantët e nënrepartëve të mbështetjes së luftimit dhe dy përfaqësues nga Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në SHP të FA-së, nënkolonel Ilir Bytici dhe nënkolonel Ardian Gjokoli. Ky aktivitet u përshëndet nga shefi i shtabit të Forcave Tokësore, kolonel Adi Ndoni, i cili pasi falënderoi pjesëmarrësit dhe organizatorët e konsideroi diskutimin për problematikën e stërvitjes para hartimit të planëzimit, si një mundësi të mirë për planëzim sa më konkret dhe vlerësim sa më të drejtë të stërvitjes. Shefi i Operacioneve dhe Stërvitjes nënkolonel Tafili, në rol të moderatorit të këtij "workshopi", u ndal kryesisht në evidentimin e arritjeve të stërvitjes gjatë vitit 2013, problematikën e hasura gjatë stërvitjes, të cilat do jenë objekt reflektimi nga mësimet e nxjerra të vitit kaluar. Njëkohësisht ai, bëri një panoramë të shkurtër mbi situatën aktuale për planëzimin e stërvitjes 2014 në FT, mbështetur në Direktivën e Ministrisë të Mbrojtjes dhe Udhëzimet e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, për stërvitjen, trajnimin dhe vlerësimin për vitin 2014. Ai theksoi për pjesëmarrësit synimin e Komandantit të Forcave Tokësore, se për të pasur kapacitete të larta operacionale, punën tonë do ta fokusojmë në funksion të përbushjes të

tre objektivave kryesore; për mbrojtjen e tërësisë territoriale të RSH, mbështetjen e autoriteteve në emergjencat civile, në ndihmë të komunitetit dhe mbështetjen e operacioneve të drejtuara nga NATO. Fokusi i diskutimeve ishin repartet dhe nënrepartet, prioritare të FT-së për vitin 2014, duke e konsideruar kompaninë e parë të b2k, prioritetin e prioritetëve dhe batalionin e dytë të këmbësorisë, si prioritetin e parë i deklaruar i dislokueshëm në fund të vitit 2014, po ashtu edhe kompaninë e MADM. Nëpërmjet kësaj tryeze pati diskutime nga të gjithë pjesëmarrësit lidhur me problematikën dhe rrugët për përmirësimin e stërvitjes. Përfaqësuesit nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, nënkolonel Ilir Bytici dhe nënkolonel Ardian Gjokoli, diskutimin e përqendruan në rëndësinë që ka stërvitja dhe vlerësimi i saj, si prioritet nr.1, për të krijuar kapacitetet operacionale. Nga konkluzionet e këtij takimi u konsiderua se viti 2014, do të shënojë një kthesë rrënjësore në planëzim, në zhvillimin dhe vlerësimin e stërvitjes. Në takim u theksua se udhëzimet e stërvitjes, të cilat janë në fazën përgatitore, të shërbejnë si themeli i përgatitjes së këtyre kapaciteteve. Rëndësi gjithashtu ju kushtua shfrytëzimit me efikasitet të burimeve financiare të vëna në dispozicion dhe infrastrukturës stërvitore që kemi në përdorim, duke u bazuar edhe në Stanag-et e ratifikuar deri tani. Gjatë diskutimit u nënvizua se para hartimit të planëzimit të bashkërendohet puna edhe me komandat e forcave dhe ato mbështetëse, me qëllim integrimin e stërvitjes.

Major Nexhbedin Basha

Dita e mjedisit në Forcat Tokësore, nis me projekte të reja dhe konkrete

Sapo futesh në ambientet e garnizonit qendër të Forcave Tokësore ndeshesh me një dekor të veshur me gjelbërim, kurora me peme dekorative, lulishte e kënde çlodhëse, të gjitha të krijuar nga dora e qindra efektivave ushtarakë dhe civilë që kanë shërbyer dhe shërbejnë në strukturat e Forcave Tokësore. Një herë në muaj, me urdhër të komandantit të FT-së, mbështetur në urdhrin e Ministrisë të Mbrojtjes, dita e martë e dytë e çdo muaji është shpallur "Dita e Mjedisit", ku efektivat ndërpresin çdo lloj aktiviteti stërvitor dhe merren vetëm me përmirësimin e mjedisit si brenda territorit në garnizone, po ashtu edhe në afërsi të rrethit ku ka komunitet. Për këtë në Komandën e FT-së dhe në repartet vartëse janë ngritur dhe funksionojnë grupe pune me përfaqësues nga degët dhe seksionet në shtab, të cilët monitorojnë dhe planëzojnë zhvillimin sa më me efikasitet të punës për përmirësimin e mjedisit. Në krye të këtij ekipi për Forcat Tokësore, është zv/komandanti Forcave Tokësore, kolonel Dilaver Hoxha, i cili shpjegon për gazetën "Ushtria" se duke qenë se jemi në fillim të vitit, kemi porositur disa ditë më pare, komandantët e repartëve dhe nënrepartëve, mbështetur në urdhrin e KFT, "Për zhvillimin e ditës së mjedisit", jo vetëm të njihet personeli me aktet ligjore e nënligjore për mbrojtjen e mjedisit, por dhe të hartojnë një Plan Veprimi "Për ditën e mjedisit". 14 janari 2014, ka qenë "Dita e Mjedisit" e Forcave Tokësore, ku efektivat në garnizone kanë kryer një volum të madh pune. Garnizoni në qendër Zall Herr dhe garnizoni i batalionit komando dhe batalionit të forcave speciale, në ditën e mjedisit, janë inspektuar nga komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, i cili ka pare nga afër ambientet në tërësi, ka përgëzuar efektivat të angazhuar në ditën e mjedisit dhe ndërkohë ka porositur që krahas mirëmbajtjes së ambienteve dhe mjedisit në përdorim, të mendohet për mbjellje të reja pemësh dekorative. "Të mbash një mjedis të pastër është kulture, ta mirëmbash atë është detyrë, ta pasurosh është domosdoshmëri. Një mjedis sa më i pastër, rrit cilësinë e ajrit dhe për këtë çdo ditë kalenderike të konsiderohet ditë mjedisi..." Kështu shprehet komandanti FT, gjeneral Dushku, për mjedisin. "Dita e mjedisit në Forcë Tokësore" në fillim të këtij



viti është vlerësuar në Forcën Tokësore. Ajo ka nisur me pastrim dhe sistemim të zyrave, depove, magazinave, parqeve, grup depove të armatimit, kabinave elektrike, depove të ujit, rrugëve, bordurave, lulishteve, kanaleve dhe kositje bari. Ka vijuar me punimin e pemëve në të gjithë garnizonet Zall Herri, Vau-Dejsit, Poshnje.

Pastrimin dhe sistemimin e

koshave kolektiv, publik dhe kazanëve në pikat e grumbullimit, heqjen e mbetjeve të ngurta dhe transportimi i tyre. Jashtë vëmendjes nuk është lënë as pastrimi i poligoneve të qitjes dhe stërvitjes. Në garnizonin qendër, batalioni i dytë ka angazhuar 200 vetë, të cilët janë marrë me detyra mjedisi jo vetëm brenda garnizonit qendër por edhe me pastrime e riparime në ambientet e rajonit Luftëtari i Çeliktë, Çakallë dhe Mëlçizë. Në këtë ditë angazhimi nuk ka munguar në asnjë repart dhe nënrepart. Kolonel Ardian Bali, shprehet se gjatë vitit 2014, kemi projekte konkrete për të përmirësuar mjedisin. Dje kemi marrë 50 rrënjë mimoza dhe i kemi mbjellë në territorin e garnizonit qendër. Gjithashtu po bashkërendojmë edhe me strukturat e pushtetit vendor dhe policinë pyjore për të mbjellë edhe bredha e pisha. Njëkohësisht po punohet nëpërmjet angazhimit në ditën e mjedisit, edhe për ndërgjegjësimin e efektivave, për të patur një mjedis sa më të pastër. Ndërsa nënkolonel Arjan Qazolli, shefi i operacioneve dhe stërvitjes, në batalionin e tretë të këmbësorisë, Poshnje Berat, informon se, në ditën e mjedisit janë angazhuar 200 vetë dhe kryesisht efektivat e këtij reparti janë marrë me pastrimin e kurorës së pyllit të repartit me sipërfaqe 13000 m2, mbjellje pemësh frutore (shëgë, fiq, ftonj, etj), higjienizimin dhe pastrimin e rrugës hyrëse prej komunës deri në repart etj. Ndërsa në Vau Dejës janë angazhuar 160 veta, ku krahas përmirësimit të mjedisit në ambientet e brendshme të garnizonit Vau Dejës, janë kryer punime për përfundimin e rrugës përqark repartit. Prioritet për ditën e mjedisit, do mbeten menaxhimi i integruar i mbetjeve, pasurimi i mjedisit ku punojmë, jetojmë dhe stërvitemi me projekte të tjera, në funksion të rritjes së cilësisë së ajrit.

Major Nexhbedin Basha

Promovimi i figurës së nënoficerit më të mirë në FD

Efektivat ballafaqohen me realizimin e detyrave në forcë e reparte

Tashmë tek ne ndodh rëndom që çdo fundviti bëhet analiza vjetore, ku efektivat ballafaqohen me realizimin e detyrave në forcë e reparte, kuptohet që marrin pjesë dhe përfaqësues nga dikasteri. Por në këtë fundviti në Forcën Detare pati dhe një moment mbresëlënës, pasi mbas analizës vjetore u përcoll me vëmendje një aktiviteti i ri: promovimi i nënoficerit më të mirë të vitit në FD. I ideuar nga kryekapiter Proletar Panxha dhe një grup nënoficerësh në Forcën Detare, Ajrore dhe Tokësore dhe i mbështetur fuqishëm nga zyra e ODS në MM, veçanërisht Major Mark Berlenbach, aktiviteti me temë: “Përzgjedhja e nënoficerit më të mirë të vitit”, vuri në lëvizje gjithë korpusin e nënoficerëve, drejtuesve në reparte, por u ndoq me interes dhe nga masa e oficerëve. Aktiviteti final në Komandën e FD u zhvillua më datën 27 dhjetor 2013, ku krahas nënoficerëve më të mirë të FD, morën pjesë kuadro të shtabit të FD, komandanti i FD, gjeneralbrigade Qemal Shkurti dhe zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralbrigade Piro Ahmetaj. Duke përshëndetur këtë ceremoni gjeneral Shkurti theksoi: “Sot ne po zhvillojmë dhe ceremoni të thjeshtë për të vlerësuar nënoficerët më të dalluar në realizimin e detyrave gjatë këtij viti. Është një punë serioze e bordit përzgjedhës, i cili për mëse një vit, evidentoi e vlerësoi ecurinë e çdo nënoficeri gjatë procesit të zbatimit të detyrave. Natyrisht këta nënoficerë me treguesit e tyre profesionalë përfaqësojnë ushtarakun model që i bën nder vetes, familjes e repartit ku shërbejnë. Por nuk janë vetëm këta, të tillë ne kemi me dhjetëra në Flotilje, QVD, repartet logjistike, anije, ndaj evidentimi dhe shpërblimi i tyre do jetë përparësi e cdo niveli komandues në Forcë”. Ai falënderoi të gjithë kuadrot nënoficerët që me përkushtim, sakrificë e kurajë kanë qenë shembull në realizimin e detyrave të përditshme në FD. Në fund të këtij procesi të vështirë grupi i punës në FD përcaktoi 10 nënoficerët më të mirë të vitit në FD, konkretisht tetar Ilir Azisllari, i cili u shpall dhe nënoficeri më i mirë i vitit në FD, nëntetar Enea Vjeshta, tetar Edmond Cara, tetar Lavdim Kokallaj, nëntetar Renato Dauti, nëntetar Ali Demollari, n/



tetar Florent Sina, tetar Marash Gjoka, rreshter Gentian Jonuzaj dhe nëntetar Afrim Aliaj. I pyetur nga ana jonë, n/oficer Kastriot Hysa, këshilltar i Komandantit të FD për n/oficerët dhe detarët profesionistë dhe protagonist i këtij aktiviteti na shpjegon ecurinë e këtij procesi thujse njëvjeçar. Në mars të 2013-ës hodhëm hapat e parë, ku bazuar në udhëzimet e ardhura nga Shtabi i FA, eksperiencën e vendeve anëtare të NATO-s dhe SHBA, ku kjo praktikë është e përhershme, ndërtuam një plan-pilot për përzgjedhjen e n/oficerit më të mirë në FD, -thotë ai. Kështu u krijua bordi i përzgjedhjes së n/oficerit i përbërë nga 5 oficerë dhe 6 n/oficerë, u përgatit procedura standarde për funksionimin e këtij bordi, u përcaktuan kuotat pjesëmarrëse në testime duke ruajtur raportin 3 kandidatura për të

zgjedhur një kandidat, u hartuan pyetësorët sipas fushave, u zhvilluan testime intelektuale dhe fizike, intervista e konkurrentëve nga bordi i përzgjedhjes, renditja e tyre sipas pikëve, tërheqja e mendimit të komandantëve për aftësitë profesionale dhe realizimin e detyrave nga kandidatët e përzgjedhur dhe njoftimi zyrtar i çdo reparti për rezultatet e këtij procesi, thekson n/oficer Kastriot Hysa. Ishte një proces i vështirë, ku duhet të kapërceheshin dhe vështirësi të llojeve të ndryshme, kuptohet që çdo metodë e re në fillimet e saj has një lloj konservatorizmi, por me ndihmën e bordit të përzgjedhjes, komandantit të FD dhe përfaqësuesve të ODS, procesi eci mbarë. Vërtet ishte një ceremoni e thjeshtë shpërndarja e certifikatave për n/oficerin më të mirë në FD, por në vetvete ajo mbarte një

mesazh të madh: -tashmë në FD puna dhe djersa e gjithsecilit, e më të mirit nuk ngelet në haresë. Ka njerëz që mbi bazën e një procesi transparent, të paanshëm dhe të përcaktuar mirë vlerësojnë punëtorin dhe të aftin për rezultatet e arritura. Pikërisht kjo ishte e bukura dhe mrekullia e këtij aktiviteti. Natyrisht që në Flotilje, QVD, kompaninë e mbështetjes logjistike, shtab, vend-bazimet Shëngjin, Sarandë, Kepi i Palit, Toga e ruajtjes dhe anije ka plot nënoficerë e detarë profesionistë që në heshtje, mbase dhe larg vëmendjes së eprorëve janë po aq të shkëlqyer e të zotë dhe padyshim që meritojnë këtë vlerësim, por ky proces që ka nisur, ky ogur i mirë, ka vijimësi dhe patjetër që do heqë “smogun” që ata i mbulon përkohësisht. Kolonele Razije

Mehmeti, shefe e Degës së Personel-Arsimit në FD thekson se, eksperiencën e këtij viti është një bazë dhe gur themeli i mirë për ta përmirësuar këtë proces në të ardhmen, duke filluar me bordin e përzgjedhjes, përmirësimin e testeve intelektuale, ndaj çdo komandant reparti ka detyrë që mbi bazën dhe të rezultateve të arritura nga çdo nënoficer apo detar profesionist të hartojë dhe TOP-listën prioritarë për kualifikimet apo kurset e ndryshme të vitit 2014. Me këtë aktivitet që përbën një risi për Forcat tona të Armatosura është hedhur një hap tjetër në metodat dhe mënyrat e vlerësimit të kuadrove më të mirë në FD, por që sigurisht në të ardhmen ka plot gjëra për tu rishikuar, si p.sh. hartimi i testeve në cilësi e përmbajtje, përfshi testet intelektuale, teste profesionale, testet e formimit, niveli i gjuhës angleze, prezantimi vetjak i çdo nënoficeri që garon në këtë proces, afati kohor më i përshtatshëm final që mund të jetë shtator-tetor i vitit 2014, pse jo dhe një shpërblim financiar për të mirët, krahas certifikatave. Ndërkohë rezultatet e këtij procesi duhen marrë në konsideratë dhe vlerësuar me pikë nga komisionet e gradimeve. Me vizion, procedura e transparencë të plotë, procesi i përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë, promovimi i vlerave të tij në dinamikën e realizimit të detyrave, larg klisheve e subjektivizmit të kohës, bëhet një proces koherent e real në FA, i mirëpritur realisht nga masa e ushtarakëve të çdo niveli.

Shefqet Kërcelli

Atasheu i ri ushtarak i SHBA, vizitoi Komandën e Forcës Detare

Më datë 10 janar atasheu i ri ushtarak i SHBA-ve, kapiten i rangut të II-të Ralph Shield i shoqëruar nga atasheu në largim nënkolonel Glenn Brown, zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare. Ushtarakët e lartë të SHBA u pritën nga komandanti i FD, gjeneralbrigade Qemal Shkurti, i cili i uroi mirëseardhjen kapiten Ralph Shield dhe suksese në detyrën e tij të re. Në vijim gjeneral Shkurti vlerësoi miqësinë tradicionale midis popullit shqiptar dhe atij amerikan si dhe bashkëpunimin e frytshëm ushtarak gjatë këtyre 20 viteve. Forca Detare ka përfituar shumë nga ndihma e popullit dhe Departamentit të shtetit të SHBA-ve, nënvizoi komandanti i FD. Kjo ndihmë ka prekur çdo fushë dhe nevojat kryesore të FD, si në teknologji, aparatura e pajisje, mjete detare të kohës, kualifikimin e personelit oficer e n/oficer të Rojës Bregdetare, trajnimin e grupeve të bordimit dhe luftën kundër akteve terroriste, stërvitje



re kapiten Shield dhe i theksoi Atij së është i mirëpritur në cdo kohë në Komandën e FD e repartet e saj vartëse, për të realizuar me sukses të gjitha projektet e bashkëpunimit. Gjithashtu komandanti i FD i uroi suksese në detyrën e re dhe atasheut në largim n/kolonel Glenn Brown. Po sot ushtarakët amerikanë vizituan dhe Qendrën Operacionale Ndërinstitucionale Detare ku u pritën nga titullarët e këtij institucioni.

546 vjetori i vdekjes së Skënderbeut

(6 MAJ, 1405 – 17 JANAR, 1468)

GEORGIUS CASTRIOTVS SCANDERBEGVS,
Epiri & Albanix &c. Princeps Anno 1444.



*Pellæus, Pyrrhusq, GEORGII in pectore, reges,
Thracem ex Epiro quando fugabat, erant.*